



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36/2019 regjistër (JR)
Datë 31.07.2019

Nr. 21 i vendimit
Datë 10.09.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 10.09.2020, ditën e enjte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Roland Jaupaj, gjyqtar, me detyrë kryetar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta dhe Aneksi i saj; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, pika 1 dhe 66, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e paraqitura në ankim dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Roland Jaupaj, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrat e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Roland Jaupaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj*.

1.3 KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv e rastësor dhe ka dërguar në Komision një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 150, datë 28.05.2019.

¹ ILDKPKI, me shkresën nr. {***} prot., datë 8.2.2018, ka dërguar në Komision raportin pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj.

² DSIK, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.2017, ka dërguar në Komision raportin për subjektin e rivlerësimit Roland Jaupaj.

³ KLD, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.04.2018, ka dërguar në Komision raportin “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 150, datë 28.05.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar dhe kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit:

- 1. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara;*
- 2. ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm;*
- 3. gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Roland Jaupaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLD-ja, si edhe denoncimeve të depozituara në Komision, nuk u gjetën indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime thelbësore për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Mbështetur në raportin e Inspektoratit të KLGj-së dhe shqyrtimin e dy denoncimeve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për këto arsye, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 12.07.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 150/1, datë 15.07.2019.
6. Në ankim dhe në parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore (në vijim “parashtrimet”), subjekti i rivlerësimit Roland Jaupaj ka kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, në kushtet kur janë kryer shkelje të rënda procedurale në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni, si dhe administrimin e provave të reja të

kërkuara prej tij, duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrat e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

7. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 150, datë 28.05.2019, janë evidentuar, në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor, si dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit

7.1 Komisioni, me vendimin e marrë dhe procedurën joligjore të ndjekur deri në komunikimin e tij, i ka cenuar subjektin të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

7.2 Komisioni është treguar i anshëm në kryerjen e procesit të rivlerësimit, pasi në të njëjtat rrethana, ka vlerësuar tërësisht në të kundërt në vendime të tjera, duke mos marrë në konsideratë e vlerësuar drejt provat e administruara, duke shkelur parimet e proporcionalitetit, mbrojtjes së konfidencialitetit dhe objektivitetit, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

7.3 Referenca ligjore në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e përdorur nga Komisioni si bazë ligjore për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është e gabuar, në rastin kur nuk përmbushen bashkërisht të dyja kushtet e kërkuara nga dispozita e referuar, për deklarim të pamjaftueshëm në kriteret e kontrollit të pasurisë dhe të figurës, pasi vetë Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

7.4 Komisioni, në vlerësimin se personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, nuk ka përllogaritur pasurinë që ka vlerësuar si jo të ligjshme, në raport me parimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, të parashikuar nga neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7.5 Subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar tërësisht të ardhurat dhe shpenzimet e tij për periudhën tetor 2003 deri në 31 dhjetor 2005, që i kanë mundur atij krijimin e një shume *cash*, e cila ka bërë të mundur hapjen e depozitës në shumën 3.011 euro në vitin 2006.

7.6 Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për justifikimin e likuiditeteve dhe shpenzimeve për vitin 2008.

7.7 Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe në deklaratimet periodike të interesave, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar të njëjtën adresë që figuron në zyrën e gjendjes civile si vendbanim e vendqëndrim, pa pasur si qëllim të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim, por Komisioni nuk ka arsyetuar e provuar “përpjekjen” për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë, si kriter të kërkuar nga ligji dhe Aneksi i Kushtetutës.

7.8 Komisioni, në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial, nuk ka zbatuar drejt ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2003”), pasi ka zbatuar ndryshimet e këtij ligji, të cilat kanë hyrë në fuqi më vonë se sa koha e kryerjes së

veprimeve nga babai i subjektit të rivlerësimit, duke i dhënë kështu ligjit fuqi prapavepruese e për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e përfitimit të trajtimit preferencial.

7.9 Konkluzioni i Komisionit, se personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2012, është i pabazuar në prova, pasi Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe kursimet e mundshme të krijuara prej tyre në vite.

7.10 Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, personi i lidhur – bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – ka deklaruar burimin e krijimit të depozitave bankare të krijuara ndër vite, si dhe ka paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e secilës prej këtyre depozitave. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për të krijuar depozitat bankare në vitin 2009.

- 8.** Në mbështetje të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh, të cilat ai ka kërkuar të shqyrtohen prej trupit gjykues të Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), pasi sipas tij ato provojnë pretendimet e ngritura në shkaqet e ankimit. Këto akte renditen si vijon.

8.1 Vërtetim, datë 09.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

8.2 Relacion teknik i inxhinierit S. S, datë 08.07.2019.

8.3 Memo, datë 08.07.2019, drejtuar Komisionit, bashkëlidhur së cilës një listë me të dhënat që pasqyrohen të ndryshme midis përmbajtjes së vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit më datë 01.07.2019, rreth orës 21:00, dhe vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit, më datë 02.07.2019, pas orës 14:00.

8.4 Vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, i publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit, më datë 01.07.2019.

8.5 Vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, i publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit, më datë 02.07.2019.

8.6 Vendimi i Komisionit nr. 150, datë 28.05.2019, me përmbajtjen e publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit, më datë 01.07.2019, dhe vendimi i Komisionit nr. 150, datë 28.05.2019, me përmbajtjen e publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit, më datë 02.07.2019, në formë digjitale, shkarkuar në formatin *PDF* nga faqja zyrtare elektronike e Komisionit, më datë 01.07.2019 e më datë 02.07.2019.

8.7 Printim i faqes zyrtare në internet të Komisionit, në të cilën është pasqyruar rubrika “Vendime të publikuara” për subjektet e rivlerësimit E. M, Dh. L, S. K.

8.8 Printim i dy ikonave kompjuterike të dy dokumenteve, një e programit *Word* me titull “Vendim ISSh” dhe e një dokumenti në *PDF*, me datë modifikimi 07.01.2019, ora 9:06 *PM*.

- 9.** Subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur pretendimet e tij, ka kërkuar gjithashtu të thirren e të dëgjohen si dëshmitarë, trupi gjykues i Komisionit që ka dhënë vendimin nr. 150, datë 28.05.2019, dhe/ose punonjës të tjerë të këtij institucioni, për të dëshmuar në lidhje me publikimin dy herë të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, me përmbajtje të ndryshme.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

10. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 150, datë 28.05.2019, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).
11. Trupi gjykues shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur me parashtrimet e tij me shkrim⁴ para zhvillimit të seancës gjyqësore, në të cilat ka kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e tij, në funksion të korigjimit të shkeljeve të rënda procedurale e të konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë të plotë e të saktë, sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, si edhe në funksion të marrjes me cilësinë e provave të reja të akteve që ai i ka bashkëlidhur ankimit.
12. Sa i takon kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve që i ka bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues, analizën për pranueshmërinë për shqyrtim ose jo të këtyre provave, e mbështeti në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”, dispozitë kjo e detyrueshme për zbatim, në referim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
Gjithashtu, analiza e këtij pretendimi u mbështet edhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.
13. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

13.1 Në lidhje me aktet “Vërtetim, datë 09.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”⁵ dhe “Relacion teknik i inxhinierit S. S, datë 08.07.2019”, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për paraqitjen e këtyre provave gjatë fazës së zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, përderisa në ankim nuk ka provuar se ishte në pamundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cituar më sipër.

13.2 Në lidhje me aktin “Memo, datë 08.07.2019” drejtuar Komisionit, bashkëlidhur së cilës gjendet dhe një listë me të dhënat që pasqyrohen të ndryshme midis përmbajtjes së vendimit nr. 150, datë 28.05.2019 i publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komisionit më datë 01.07.2019, rreth orës 21:00 dhe vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, i publikuar në faqen

⁴ Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.07.2020, ka depozituar në Kolegjin parashtrimet me shkrim para zhvillimit të seancës gjyqësore, të cilat janë protokolluar me nr. {***} prot., datë 22.07.2020.

⁵ Akti “Vërtetim, datë 09.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” sqaron se për muajin korrik 2008, subjektit të rivlerësimit i janë paguar shpërblim + dieta në vlerën 66.000 lekë, nga të cilat 10.000 lekë shpërblim, 10.000 lekë dieta për periudhën dhjetor 2006 i komanduar në Gjykatën Kurbin, 36.000 lekë dieta për periudhën janar - qershor 2007 i komanduar në Gjykatën Kurbin, 10.000 lekë dieta për periudhën mars - qershor 2008 për trajnime në Shkollën e Magjistraturës.

zyrtare elektronike të Komisionit më datë 02.07.2019, pas orës 14:00, trupi gjykues vëren se akti përmban shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me ndryshimet e konstatuara prej tij, ndërmjet vendimeve të pretenduara se janë publikuar nga Komisioni, në dy data të ndryshme. Duke qenë se në ankim, subjekti nuk ka shpjeguar cilat janë ndryshimet ndërmjet dy vendimeve të pretenduara prej tij si të publikuara nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson që aktin “Memo, datë 08.07.2019” dhe listën bashkëlidhur tij, t’i trajtojë si vazhdimësi e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim.

13.3 Në lidhje me aktet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç janë cituar në paragrafët 8.4 - 8.8 të këtij vendimi, me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit, në kuadër të pretendimit të tij për cenim të procesit të rregullt ligjor, kërkon të provojë parregullsitë lidhur me publikimin e vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, nga Komisioni, trupi gjykues refuzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr. 84/2016, pasi këto akte nuk provojnë në asnjë rast se vendimet e pretenduara prej tij si të publikuara nga Komisioni, me përmbajtje të ndryshme, në data të ndryshme, janë akte autentike të këtij të fundit e aq më tepër që janë publikuar në data të ndryshme.

Trupi gjykues po ashtu refuzoi dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të thirrur si dëshmitarë, trupin gjykues të Komisionit dhe/ose punonjës të tjerë të këtij institucioni, për të dëshmuar në lidhje me publikimin dy herë të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, me përmbajtje të ndryshme.

Arsyetimi i plotë në lidhje me këtë vlerësim jepet më poshtë, në trajtimin nga trupi gjykues të shkakut të ankimit, me të cilin lidhet qëllimi i paraqitjes së këtyre akteve nga subjekti i rivlerësimit.

14. Në Kolegj janë depozituar katër denoncime për subjektin e rivlerësimit Roland Jaupaj. Denoncimet e protokolluara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 31.10.2018 dhe nr. {***} prot., datë 07.5.2019, janë paraqitur nga e njëjta denoncuese, znj. L. O. Z., ndërsa denoncimet e protokolluara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 23.12.2019 dhe nr. {***} prot., datë 25.06.2020, janë paraqitur nga z. G. T, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Sindikatës së Pavarur të Naftës, {***}.

Pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi mosfillimin e hetimit kryesisht, pasi nuk përmbanin informacione të mjaftueshme për t’u hetuar.

15. Trupi gjykues vlerësoi se nga kontrolli i zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, në raport me pretendimet e parashtruara në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me sa pretendon ky i fundit, nuk u evidentua ndonjë shkelje procedurale apo konstatim i gabuar i situatës faktike, në kuptim të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e zhvillimit të debatit gjyqësor, me qëllim korigjimin e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

16. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni, me vendimin e marrë dhe procedurën joligjore të ndjekur deri në komunikimin e tij, i ka cenuar subjektin të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në bazë të nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i ka lidhur me pretendimin se vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, është publikuar dy herë në faqen zyrtare në internet të Komisionit, çdo herë me përmbajtje të ndryshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi përfundimtar është publikuar në faqen

zyrtare elektronike të Komisionit më datë 01.07.2019, ora 21:00 dhe më datë 02.07.2019 është hequr nga faqja zyrtare e Komisionit për t'u ripublikuar pas orës 14:00. Komisioni, më datë 04.07.2019, i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit zyrtarisht, nëpërmjet shërbimit postar, vendimin nr. 150, datë 18.05.2019, i cili është i ndryshëm në përmbajtje me vendimin e publikuar më datë 01.07.2019, në faqen zyrtare në internet të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, në kushtet kur nuk është vënë në dijeni të ndonjë procedure për konstatim dhe ndreqje gabimi material në vendim dhe as për shkakun, motivin dhe procedurën ligjore të ndjekur në këtë rast, Komisioni, me veprimet e kryera në publikimin të më shumë se një herë të arsyetimit të vendimit, pasqyrimin e rremë të publikimit të tij në faqen zyrtare elektronike më datë 01.07.2019, ndërkohë që përmbajtja është ndryshuar më datë 02.07.2019, mosvënien në dijeni të tij si palë në proces, moskthimin përgjigje dhe anashkalimin e kërkesës për datën e publikimit të vendimit, i ka shkaktuar dëm atij. Komisioni, pretendon subjekti i rivlerësimit, ka shkelur parimet e transparencës, informimit dhe të përgjegjësisë, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

17. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionit, me datë publikimi 01.07.2019, dhe përmbajtjes së vendimit që gjendet në dosjen e përcjellë nga Komisioni në Kolegj, për efekt të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, konstaton se përmbajtja e tyre është e njëjtë.
18. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se pika 7 e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016⁶ vendos detyrimin që subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë t'u njoftohet vendimi me shkrim, në të cilin janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, ashtu siç është parashikuar në pikën 1 të nenit 57 të po këtij ligji, sipas të cilit relatori i çështjes arsyeton me shkrim vendimin e Komisionit, si dhe në pikat në vijim të po këtij neni, në të cilat janë përcaktuar elementet e përmbajtjes së vendimit të Komisionit.
Qëllimi i dispozitave të sipërcituara është që subjektit të rivlerësimit t'i njoftohet vendimmarrja e Komisionit në formën e aktit të shkruar, i cili duhet të njoftohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe substanciale, të cilat garantojnë marrjen dijeni të subjektit për këtë akt. Njohja e subjektit të rivlerësimit me vendimin me shkrim të Komisionit, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
Nga leximi në harmoni i neneve të sipërcituara të ligjit nr. 84/2016, rezulton se afati i paraqitjes së ankimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me njoftimin e subjektit të rivlerësimit me vendimin me shkrim të Komisionit.
19. Në vështrim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedurën e ndjekur deri në komunikimin e vendimit, duhet të vlerësohen në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes së subjektit të rivlerësimit, duke qenë se pretendimet e tij kanë të bëjnë në thelb me cenimin e procesit të rregullt ligjor, edhe pse subjekti nuk ka shprehur konkretisht se cili nga elementet e këtij procesi është cenuar. Për këtë arsye, trupi gjykues çmon të vlerësojë nëse Komisioni ka përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të kërkesave procedurale për njoftimin e vendimit.

⁶ Neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: "7. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit".

20. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, trupi gjykues konstaton se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.07.2019, me lëndë: “Njoftim vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj”, drejtuar subjektit të rivlerësimit, ka kryer njoftimin e këtij të fundit me vendimin e marrë për të. Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, gjendet dëftesa postare, e cila mban datën 01.07.2019, si datë e dorëzimit të akteve nga Komisioni në shërbimin postar dhe datën 04.07.2019, si datë e dorëzimit të akteve nga shërbimi postar te subjekti i rivlerësimit. Dëftesa e marrjes së akteve është nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj. Ky fakt është pranuar nga subjekti i rivlerësimit në ankimin e depozituar prej tij në Komision⁷, i protokolluar me nr. {***} prot., datë 12.07.2019. Trupi gjykues çmon të theksojë se subjekti i rivlerësimit, në ankim, në kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit, i është referuar përmbajtjes së vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, me të cilin është njohur më datë 04.07.2019, nëpërmjet shërbimit postar.
21. Në vështrim të kërkesave procedurale⁸ lidhur me njoftimin e vendimit subjektit të rivlerësimit, si dhe të rrethanave konkrete të çështjes të konstatuara më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni ka kryer të gjitha veprimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për njoftimin personalisht të subjektit të rivlerësimit me vendimin nr. 150, datë 28.05.2019; subjekti i rivlerësimit është njohur me këtë vendim dhe ka ushtruar dhe të drejtën e ankimit, për pasojë atij nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të garantimit të së drejtës së ushtrimit të ankimit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Në vlerësim të trupit gjykues, publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet të Komisionit nuk ka vlerë të posaçme për efekt të njoftimit të subjektit të rivlerësimit, pasi është një mjet që nuk garanton në asnjë rast marrjen dijeni të subjektit të rivlerësimit për publikimin e vendimit dhe aq më tepër nuk garanton njohjen e subjektit me përmbajtjen e plotë të tij, qoftë edhe vetëm për faktin se të dhënat e pasqyruara në të janë të anonimizuara. Publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet i shërben njohjes së publikut me vendimmarrjen e Komisionit për një subjekt rivlerësimi, në funksion të realizimit të qëllimit të shpallur në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.
22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, duke publikuar dy herë të njëjtin vendim, ka shkelur parimet e transparencës, informimit dhe të përgjegjësisë, parime të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në fashikull, pasi, siç u analizua më sipër, Komisioni ka zbatuar parashikimet ligjore në njoftimin e subjektit të rivlerësimit me vendimin e shkruar, vendim i cili, siç rezulton nga aktet e fashikullit gjyqësor, nuk ka pësuar ndryshime për ndreqje gabimesh. Trupi gjykues konstaton se subjekti, pretendimet për shkeljen e parimeve të transparencës, informimit dhe përgjegjësisë, nuk i ka analizuar lidhur me rrethana konkrete, që të argumentojë pretendimet e tij për shkelje të këtyre parimeve.

⁷ Në ankim, subjekti i rivlerësimit është shprehur: “Në datë 04.07.2019, mora zyrtarisht nëpërmjet shërbimit postar, me zarf, vendimin nr. 150, datë 28.05.2019 të Komisionit [...]”.

⁸ Sipas neneve 148 dhe 149 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Neni 148 parashikon se: “1. Njoftimi, kur pala është e pranishme, mund të bëhet verbalisht, apo në çdo mënyrë tjetër të përshatshme të njoftimit. 2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.

Neni 149 parashikon se: “1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kod, njoftimi i bëhet palës personalisht. Përrjashtimisht, kur organi publik është njoftuar për caktimin e një përfaqësuesi ose personit përgjegjës për njoftimet, njoftimi i bëhet këtij të fundit. 2. Njoftimi që i bëhet përfaqësuesit ose personit përgjegjës të njoftimeve, vlerësohet se i është bërë personalisht palës”.

Subjekti, megjithëse ka pretenduar se i është shkaktuar dëm nga publikimi dy herë i vendimit, nuk ka identifikuar dhe argumentuar konkretisht se cili është ky dëm.

Edhe në rast se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në faqen zyrtare në internet të Komisionit, janë publikuar dy herë, dy vendime me përmbajtje të ndryshme, në data të ndryshme, do të konsiderohej i mirëqenë, nga ndryshimet e konstatuara nga vetë subjekti mes dy vendimeve të pretenduara, vërehet se ato janë të lidhura, kryesisht, me renditje të ndryshme fjalësh e frazash, por qëndrimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e fakteve e provave e, si rezultat, dhe konkluzioni përfundimtar i tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, nuk ndryshojnë. Po ashtu, mbetet i njëjtë edhe qëndrimi i Komisionit në drejtim të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, e vendosur në pjesën urdhëruese të vendimit. Trupi gjykues, në vijim të konkluzionit se nuk është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për të ushtruar ankimin, e gjen edhe këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit të paargumentuar.

23. Në shqyrtim të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni, duke bërë publike në vendim – hequr me dashje anonimizimin e të dhënës personale e konfidenciale – i ka shkaktuar dëm atij, si dhe ka shkelur parimin e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar në ankim se cilat janë konkretisht të dhënat e publikuara nga Komisioni, mosanonimizimi i të cilave ka shkelur parimet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, por në listën me të dhënat e ndryshme të vendimeve të pretenduara si të publikuara në data të ndryshme, të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur ankimit⁹, ai ka referuar disa të dhëna të mbetura të paanonimizuar në vendimin e Komisionit nr. 150, datë 28.05.2018. Në verifikim të pretendimit të subjektit, nga leximi i përmbajtjes së vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, i cili është i publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionit, rezulton se në paragrafin 40.1.2 ka mbetur i paanonimizuar një numër llogarie bankare i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe në paragrafin 62.5.1 është përmendur emri i njëjës prej palëve ndërgjyqëse në një nga vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.
24. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se publikimi dhe anonimizimi i vendimit janë çështje që i përkasin sferës së veprimtarisë administrative të Komisionit, bazuar në nenin 49, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “5. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, sipas këtij neni, u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni ose Kolegji i Apelit merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në format elektronik, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale”. Në mbështetje të këtij parashikimi, si dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë”, trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i këtij pretendimi del jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Kolegjit. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se dëshmia e trupit gjykues të Komisionit e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, është e panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr. 84/2016.

⁹ Në paragrafin 13.2 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerësoi që aktin “Memo, datë 08.07.2019” dhe listën bashkëlidhur tij, t’i trajtojë si vazhdimësi e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim.

Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se subjektit të rivlerësimit nuk i është cenuar e drejta e ushtrimit të ankimit dhe, për këtë arsye, pretendimi i tij mbetet i paargumentuar dhe i pabazuar.

25. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit: *Komisioni është treguar i anshëm në kryerjen e procesit të rivlerësimit, pasi në të njëjtat rrethana, ka vlerësuar tërësisht në të kundërt në vendime të tjera, duke mos marrë në konsideratë e vlerësuar drejt provat e administruara, duke shkelur parimet e proporcionalitetit, mbrojtjes së konfidencialitetit dhe objektivitetit, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në argumentimin e tij për këtë shkak ankimi, ka cituar disa vendime të Komisionit, si vendimi nr. 62, datë 03.08.2018 dhe vendimi nr. 158, datë 29.05.2019. Subjekti pretendon se në rastin e tij, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me këtë praktikë, duke u treguar i anshëm e duke shkelur parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
26. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit në lidhje me anshmërinë e trupit gjykues të Komisionit, megjithëse lidhet me qëndrimin e kundërt të mbajtur nga të njëjtët anëtarë të trupit gjykues në çështje të ngjashme, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim duhej paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, pasi qëndrimi i Komisionit në lidhje me çështje të caktuara është shprehur paraprakisht që në rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të hetimit administrativ. Në verifikim të qëndrimit të subjektit në lidhje me këtë pretendim të parashtruar në ankim, nga aktet e administruara nga Komisioni, rezulton se subjekti, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me anshmërinë e ndonjë anëtari të trupit gjykues dhe as nuk ka paraqitur kërkesa procedurale të lidhura me këtë shkak. Nga procesverbali i seancës dëgjimore të Komisionit, datë 27.05.2019, rezulton se kërkesës së kryesueses së seancës për të shprehur qëndrimin e tij përfundimtar, në lidhje me procesin e rivlerësimit të zhvilluar ndaj tij, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Shpreh qëndrimin maksimal për të nderuarën trupë gjyqëse, për punën që kanë bërë në kuadrin e procesit të rivlerësimit tim si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e me besim te këta, kërkoj që të vlerësohem i përshtatshëm [...] e të konfirmohem në detyrë për vazhdimin e saj.*
27. Trupi gjykues vlerëson se çështjet e cenimit të paanshmërisë së anëtarit të trupit gjykues për shkak të qëndrimeve të mbajtura prej tij, duhet të konstatohen gjatë zhvillimit të gjykimit, në lidhje me realizimin e një procesi të rregullt ligjor, dhe jo për shkak të një vendimmarrjeje në disfavor të subjektit. Në vendimin nr. 150, datë 28.05.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, Komisioni është shprehur bazuar në faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit dhe që janë administruar prej tij, duke pasqyruar mënyrën e vlerësimit dhe të interpretimit të provave, si dhe duke arsyetuar dhe argumentuar secilën prej çështjeve që kanë çuar në arritjen e përfundimeve dhe, për pasojë, në qëndrimin e mbajtur në dispozitiv, për dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese¹⁰, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi, dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, në përputhje edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: *Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor*. Nuk është roli i Kolegjit, madje edhe në rastet që në pamje të parë duken të

¹⁰ Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës: “5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.

krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni, për subjekte të ndryshme.

Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i paargumentuar dhe i pabazuar.

28. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *referenca ligjore në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e përdorur nga Komisioni si bazë ligjore për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, është e gabuar, në rastin që nuk përmbushen bashkërisht të dyja kushtet e kërkuara nga dispozita për deklarim të pamjaftueshëm në kriteret e kontrollit të pasurisë dhe figurës, pasi vetë Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës*, trupi gjykues konstaton se shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit nuk ka ardhur si pasojë e papërshtatshmërisë së tij për vazhdimin e detyrës lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, por Komisioni ka vendosur këtë masë disiplinore, bazuar në kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi konkluzionet e arritura për këtë kriter vlerësimi përmbushnin kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në referim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
29. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të theksojë se Kolegji ka krijuar tashmë një jurisprudencë të konsoliduar në interpretimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se është e panevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarimin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas parashikimeve të nenit 39 dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, parashikohen si raste të veçuara në kuadër të pamjaftueshmërisë në deklarim. Vlerësimi për secilin prej tyre, bazohet në dispozita të ndryshme, të cilat trajtojnë dy kriteret e ndryshme të kontrollit në procesin e rivlerësimit. Në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, që do të thotë se ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit vetëm për një kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, bazuar vetëm në një kriter vlerësimi. Në këtë kuptim, nuk kërkohet që deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë, të ekzistojnë detyrimisht njëkohësisht që të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por mjafton vetëm njëri prej tyre për të arritur në këtë përfundim. Në konkluzion, edhe për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se mbetet i pabazuar.
30. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni, në vlerësimin se personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, nuk ka përllogaritur pasurinë që ka vlerësuar si jo të ligjshme, në raport me parimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, të parashikuar nga neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstaton se, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, Komisioni, në vendim¹¹, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:
- (i) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara;
 - (ii) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm;
 - (iii) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

¹¹ Paragrafi 49.3 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

31. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka parashtruar kundërshtitë e tij në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, duke i përqendruar pretendimet e tij në interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se nga situata ku informaliteti për disa dekada është pranuar si një rregull sjelljeje për individët dhe institucionet publike, ligjvënësi është detyruar të normojë në pikën 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, prezumimin e pafajësisë për shkarkim për rastin kur pasuria nuk e kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme. Niveli bazë për të llogaritur mospërgjegjësinë fillon nga koncepti “pasuri e ligjshme” deri në dyfishin e vlerës së saj. Nga formulimi kushtetues i pikave 4 dhe 5 të nenit D, nëpërmjet një interpretimi *a contrario*, arrihet në konkluzionin se në rastin kur rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar dyfishin e pasurisë, por vërtetohet se është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, atëherë do të mjaftojë vetëm ky shkak për ta prezumuar atë fajtor për shkarkim. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu se, në asnjë rast Komisioni, edhe nëse merren për bazë konkluzionet e tij, nuk ka përlllogaritur pasurinë që ka vlerësuar si jo të ligjshme, në raport me parimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, pasi nëse do të bëhej një vlerësim i tillë, nuk do të plotësoheshin kriteret për shkarkim, për shkak të mosjustifikimit të pasurisë.
32. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, referuar gjithë arsytimit dhe përmbajtjes së vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, trupi gjykues konstaton se në arsyetimin apo dispozitivin e tij, Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim lidhur me pasjen e dyfishit të pasurisë së ligjshme nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Referuar dispozitivit të këtij vendimi, rezulton që masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit është dhënë bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- Trupi gjykues, në mbështetje edhe të qëndrimit të mbajtur në mënyrë konstante në jurisprudencën e Kolegjit, sjell në vëmendje se neni D i Aneksit të Kushtetutës rregullon procedurën e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Secili prej paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, të lidhur me rrethanat sipas të cilave prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Secila nga këto rrethana është projektuar në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke e materializuar sanksionimin kushtetues me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, neni D i Aneksit të Kushtetutës është pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë, duke prodhuar masa disiplinore të veçuara nga njëra-tjetra.
33. Bazuar në arsyetimin e bërë më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, ka kundërshtuar përfundimin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në krijimin e pasurive në pronësi të tij, trupi gjykues vlerëson të mbajë qëndrimin e tij në lidhje me këtë shkak ankimi në raport me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në harmoni me konkluzionin përfundimtar të arritur prej tij në vlerësimin tërësor të çështjes.
34. Në konkluzion, duke qenë se konstatohet që përcaktimi i nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet dhënia e masës së shkarkimit nga detyra për rastet kur rezulton se subjekti ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, nuk është aplikuar në këtë rast nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për zbatim të gabuar të kësaj dispozite, nuk qëndron.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

35. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin e Komisionit për konkluzionet lidhur me pasuritë e tij, vlerësimi i të cilave ka ndikuar në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, duke vlerësuar si më poshtë.
36. *Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar tërësisht të ardhurat dhe shpenzimet e tij për periudhën tetor 2003 deri në 31 dhjetor 2005, që i kanë mundësuar krijimin e një shume cash, e cila ka bërë të mundur hapjen prej tij të depozitës në shumën 3.011 euro në vitin 2006, trupi gjykues konstaton se është kundërshtuar konkluzioni i Komisionit, në vendim¹², në lidhje me këtë depozitë, se: “Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e depozitës në shumën 3.011 euro në datën 25.09.2006, duke rezultuar me një balancë negative prej 113.210 lekësh”. Kundër këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij, duke pretenduar se si burim krijimi për këtë depozitë kanë shërbyer edhe kursimet e tij cash gjatë vitit 2005, në vlerën 250.000 lekë, të cilat janë realizuar nga të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës në vitet 2003-2005, si dhe nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për periudhën 3.10.2005 - 31.12.2005, por që nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë për shkak të mosdeklarimit të tyre nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se mospasqyrimi në deklaratën periodike të vitit 2005 i të dhënës për gjendje lekësh cash, ka ardhur si pasojë e mosinstruktimit për mënyrën e plotësimit të të dhënave, në këtë deklaram të parë të pasurisë. Mosdeklarimi i gjendjes cash prej 250.000 lekësh në këtë deklaratë, ka ardhur si pasojë e mendimit të tij se për veprimet monetare të kryera, vlerësohet sasia e të ardhurave të ligjshme dhe e shpenzimeve të dokumentuara sipas ligjit, ndërsa diferenca e pashpenzuar nënkuptohet si kursim cash. Këtë pretendim, subjekti e ka pasqyruar edhe në “Opinionin mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit”¹³ (në vijim “shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ”), në përgjigje të gjetjes së Komisionit se ai nuk justifikonte me burime të ligjshme, krijimin e kësaj depozite në vitin 2006.*
37. Në analizë të këtij shkakun ankimi, trupi gjykues vëren se në lidhje me këtë depozitë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin¹⁴, si vijon:
“Depozita prej 1.500 eurosh në Bankën Raiffeisen, dega Tiranë, datë 24.03.2006 - 24.09.2006, e realizuar me të ardhurat e rrjedhura nga paga si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Kurbin. Vlera 1.500 euro. Pjesa takuese 100%.
Interes bankar i përfituar nga depozita prej 1.500 eurosh në Bankën Raiffeisen, dega Tiranë. Vlera 12,59 euro. Shtim i depozitës prej 1.512,59 eurosh me 1.500 euro, duke shkuar depozita prej 3.000 eurosh në Bankën Raiffeisen, dega Tiranë, 25.09.2006 - 25.03.2007, e realizuar me të ardhurat e rrjedhura nga paga si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Kurbin. Vlera 3.012,59 euro. Pjesa takuese 100%”.
Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI ndër vite dhe të përcjella nga kjo e fundit në Komision, rezulton se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “Depozitë me afat, data e çeljes 25.09.2006, numër llogarie {***}. Vlera 3.011 euro. Pjesa takuese: 100%.”

¹² Paragrafët 34.3 - 34.5.1 të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

¹³ “Opinionin mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit” është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, më datë 23.05.2019.

¹⁴ Deklarata e pasurisë për rivlerësimin, është dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017.

Ndërsa në deklaratën periodike të interesave të vitit 2005, e cila është edhe deklarata e parë e interesave e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, ai nuk ka deklaruar gjendje parash *cash*, të disponuara prej tij, më datë 31.12.2005.

38. Në analizë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me deklaratimet e tij të interesave në vitet 2005 dhe 2006, si dhe me kuadrin ligjor të zbatueshëm për këtë çështje, trupi gjykues vëren se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), sipas përcaktimeve të tij në mars të vitit 2006, kohë në të cilën është bërë deklarimi prej subjektit, në nenin 4 parashikonte: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]” Kjo dispozitë përcaktonte detyrimin e zyrtarëve deklarues për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash* në çdo deklaram periodik. Formulari i deklarimit të pasurisë për vitin 2005, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së dhe i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit¹⁵, në faqen 3, ka përshkruar mënyrën se si duhen deklaruar interesat duke udhëzuar zyrtarët të deklarojnë çdo ndryshim (shitesë dhe pakësim) të interesave pasurorë, si vijon: “Të gjitha llojet e pasurive të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, sendet me vlerë të veçantë 5.000 dollarë (ose i barasvlershmi i tij në lekë shqiptare), vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, që disponon brenda dhe jashtë vendit zyrtari, bashkëshortja dhe fëmijët në moshë madhore”.
39. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, pretendimi i subjektit se mungesa e deklarimit të parave *cash* në vlerën 250.000 lekë gjendje më 31.12.2005 ka ardhur si pasojë e mosinstruktimit për mënyrën e plotësimit të të dhënave në deklaratën e parë të pasurisë, nuk qëndron, pasi për të plotësuar deklaratën e interesave privatë në mënyrë të plotë e të saktë, duke pasqyruar gjendjen reale të pasurive, mjaftonte vetëm një lexim i kujdesshëm i ligjit dhe formularit të deklarimit. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të interesave privatë përcaktojnë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca e tyre si diferencë mes të ardhurave dhe shpenzimeve, siç pretendon subjekti.
40. Subjekti, në shkakun e ankimit, ka pretenduar gjithashtu se nuk ka një mënyrë tjetër të provuari se ai ka pasur gjendje *cash* vlerën 250.000 lekë në fund të vitit 2005, përveç deklaratimeve të tij gjatë hetimit administrativ në Komision. Për këtë arsye, ai pretendon se në bazë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është në pamundësi të ribërjes së deklaratës së interesave të vitit 2005 dhe, në këto kushte, ai vërteton bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të depozitës prej 3.011 eurosh, duke u bazuar në të ardhurat e realizuara dhe natyrën e shpenzimeve të kryera prej tij për periudhën tetor 2003 - dhjetor 2005, që i kanë mundësuar atij krijimin e një shume *cash* në fund të vitit 2005, të cilën e ka përdorur për hapjen e depozitës më datë 25.09.2006.
41. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ai lidhet me deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, e cila është përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision dhe është pjesë e dosjes së rivlerësimit të subjektit, e përcjellë nga Komisioni në

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit, deklarimin e interesave për vitin 2005 e ka pasur deklarim për herë të parë, por në këtë kohë, nuk ishte miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm një formular i posaçëm për kategorinë e zyrtarëve që deklarorin për herë të parë [megjithëse sipas nenit 9 të ligjit nr. 9049/2003 parashikohej deklarimi para fillimit të punës], prandaj subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit në formatin e deklarimit periodik vjetor të interesave.

Kolegj. Në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga institucionet e rivlerësimit. Pra, dokumenti i pretenduar nga subjekti - deklarata e interesave privatë të vitit 2005, e dorëzuar prej tij në ILDKPKI – ekziston dhe ka vlerën e provës në këtë proces.

Sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Ribërja e dokumentit, sipas këtij parashikimi, nuk nënkupton ribërjen e një dokumenti me një përmbajtje të ndryshme nga ajo e hartuar shumë vite më parë, për shkakun e vetëm se përmbajtja e hartuar më parë, nuk plotëson pritshmëritë e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e pasurive të realizuara e deklaruara prej vetë atij. Në rastin konkret, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2005, në deklaratën e interesave të këtij viti, e cila është administruar në cilësinë e dokumentit me vlerë të plotë provuese në këtë proces. Vlera provuese e deklaratave të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, merr rëndësi të posaçme në procesin e rivlerësimit në rastin e vlerësimit të deklaratimit të subjektit në lidhje me gjendjen e parave *cash*, jashtë sistemit bankar. Në këto raste, prova e vetme e vërtetësisë së deklaratimit të subjektit të rivlerësimit mbetet ajo çka është deklaruar prej tij në deklaratën periodike.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar, pasi deklarata e interesave privatë të vitit 2005, ekziston dhe, mbi të gjitha, ka vlerën e provës në këtë proces dhe mbi këtë bazë rezultojnë e provuar se ai nuk e ka pasur gjendje në fund të vitit 2005, vlerën prej 250.000 lekësh, të pretenduar në ankim.

Në këto rrethana, me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë shumën prej 250.000 lekësh në zërin e të ardhurave, në analizën financiare të vitit 2006, të kryer për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitës prej 3011 eurosh.

42. Duke u mbështetur në arsyetimin si më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për vitin 2006, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 137.913 lekë, për krijimin e depozitës në shumën 3011 euro, në Bankën Raiffeisen, më datë 25.09.2006.

Në këto kushte, Kolegji e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit edhe për rezultatin e analizës financiare, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimit të ligjshëm për krijimin në vitin 2006, të depozitës në Bankën Raiffeisen, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shkakun e ankimit është i pabazuar në prova.

43. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ka pasur burime financiare të ligjshme për justifikimin e likuiditeteve dhe shpenzimeve për vitin 2008*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim¹⁶, ka konkluduar se “subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara dhe shpenzimeve të kryera për vitin 2008, në vlerën 79.493 lekë.”

Në kundërshtim të këtij konkluzioni, në lidhje me disa të dhëna të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij nëpërmjet pretendimeve të paraqitura si më poshtë.

44. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni për vitin 2008 në mënyrë të gabuar ka përllogaritur pagën e tij në vlerën 873.236 lekë, duke u bazuar në një vërtetim të

¹⁶ Paragrafi 34.14 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

pagës¹⁷ dhe jo në kreditimin e llogarisë bankare në shumën 925.181 lekë, trupi gjykues verifikoi vlerën e pagave të kaluara në favor të subjektit të rivlerësimit në llogarinë e pagës, pranë Bankës Intesa San Paolo. Në këtë llogari bankare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për vitin 2008, ka kaluar vlerën 856.000 lekë në total, me përshkrimin “paga”. Nga verifikimi i debitimeve dhe kreditimeve në këtë llogari, rezulton se më datë 25.07.2008, në favor të subjektit të rivlerësimit ka kaluar shuma 66.000 lekë, me përshkrimin “dieta dhe shpërblim”, dhe më datë 22.12.2008, ka kaluar vlera 3.000 lekë, me përshkrimin “dieta”.

Në ankim, subjekti ka argumentuar se vlera prej 66.000 lekësh, e kaluar në korrik 2008 në llogarinë bankare, përbëhet nga 10.000 lekë shpërblim; 10.000 lekë dietë për komandimin për gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin për periudhën dhjetor 2006, të pamarrë më parë dhe të kredituara në korrik të vitit 2008; 36.000 lekë dietë për komandimin për gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin për periudhën janar - qershor 2007, të pamarrë më parë dhe të kredituara në korrik 2008, si dhe 10.000 lekë dietë për trajnime për periudhën mars - qershor 2008, të kredituara në korrik të vitit 2008.

Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjes se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimeve të kryera, për vitin 2008. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të paraqitura në Komision, subjekti ka renditur në të ardhurat e tij për vitin 2008 edhe zërat “shpërblim/dietë, datë 25.07.2008: 66.000 lekë” dhe “dietë, datë 22.12.2008: 3.000 lekë”. Në këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar që dietat e sipërcituara të kenë qenë dieta të kredituara në vitin 2008 për veprimtari të kryera në vitet 2006 e 2007 për komandimin për gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, por këtë pretendim e ka ngritur për herë të parë në ankim, duke pretenduar gjithashtu provimin e këtyre fakteve të reja me anë të vërtetimit, datë 09.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të paraqitur bashkëlidhur ankimit. Në pamundësi të subjektit të rivlerësimit për të provuar se pa fajin e tij nuk ka mundur ta paraqesë gjatë hetimit administrativ në Komision, ky akt nuk u pranua nga trupi gjykues në cilësinë e provës në këtë proces, në përputhje me parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se dietat në vlerën prej 46.000 lekësh, si dieta që u përkasin viteve 2006 e 2007, por të kredituara në vitin 2008, duhet të përlllogariten si të ardhura për vitin 2008, mbetet i paprovuar. Të njëjtin qëndrim, trupi gjykues mban edhe në lidhje me vlerën prej 10.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti si “shpërblim” i marrë në vitin 2008, pasi mbetet e paprovuar vlera e saktë e këtij shpërblimi, në kushtet kur ai ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shumën e dietave, në një transaksion të përbashkët me vlerë totale 66.000 lekë.

Në vlerësim të trupit gjykues, në të ardhurat e vitit 2008, nuk duhet të konsiderohet as vlera 10.000 lekë e pretenduar nga subjekti si dietë për trajnime për periudhën mars - qershor të vitit 2008, si edhe vlera 3.000 lekë, e kaluar në llogarinë bankare të subjektit me përshkrimin “dietë”, më datë 22.12.2008, pasi “dieta” është kompensim për një shpenzim të kryer më parë dhe jepet për efekt rimbursimi të shpenzimit të kryer, pa plotësuar kështu kushtet për t’u kualifikuar si “e ardhur”. Në total, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “të ardhura nga paga” për vitin 2008, ka kaluar vlera 856.000 lekë. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në llogarinë bankare të pagës ka kaluar vlera 925.181 lekë. Në kushtet, kur vlera e pagës e përlllogaritur nga Komisioni është në vlerën 873.236 lekë, sipas vërtetimit të pagës të lëshuar

¹⁷ Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 18.01.2017, është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, si dokumentacion justifikues, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Sipas këtij vërtetimi, paga e subjektit të rivlerësimit për vitin 2008, ka qenë në vlerën 873.236 lekë.

nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, trupi gjykues do të konsiderojë këtë vlerë në analizën financiare, pasi kjo është shuma e kontestuar nga subjekti i rivlerësimit.

45. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka sqaruar metodologjinë e përdorur në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në vlerën 136.000 lekë. Ai ka pretenduar se vlera prej 75.700 lekësh, e përlllogaritur nga Komisioni në analizën financiare, në zërin “shpenzime të tjera”, duhet të përlllogaritet brenda vlerës së shpenzimeve të jetesës, pasi në deklaratet e tij gjatë hetimit administrativ, ai nuk ka nënkuptuar aspak përjashtimin e harxhimit të kësaj shume si shpenzime jetese.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, në analizën financiare të vitit 2008, krahas vlerës së shpenzimeve të jetesës në vlerën 125.235 lekë, ka vendosur edhe zërin “shpenzime të tjera” në vlerën 75.700 lekë. Më datë 02.12.2008, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e tij bankare, shumën 605.700 lekë. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008, ka deklaruar vlerën 530.000 lekë, si kursime *cash*. Gjatë hetimit administrativ, pyetjes së drejtuar nga Komisioni¹⁸, se cili ka qenë destinacioni i shumës 605.700 lekë, subjekti i është përgjigjur se është tërhequr për t’u mbajtur gjendje *cash* dhe nga kjo vlerë, pas harxhimit të një pjese të vogël, ka mbetur vlera 530.000 lekë, e deklaruar si gjendje *cash*. Bazuar në këto rrethana faktike, trupi gjykues, në pamundësi për të kuptuar se pse Komisioni ka përlllogaritur si shpenzime jetese vlerën 125.235 lekë, vlerëson se është i drejtë pretendimi i subjektit se vlera prej 75.700 lekësh duhet të ishte përlllogaritur si pjesë e shpenzimeve të jetesës, në kushtet kur, përveç kursimeve *cash*, nuk ka deklaruar krijimin e ndonjë pasurie në këtë periudhë. Komisioni nuk duhet të kishte përlllogaritur vlerën 75.700 lekë, si zë të veçantë shpenzimi, por duhet ta kishte konsideruar si pjesë të shpenzimeve të jetesës. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se shpenzimet e jetesës duhet të ishin përlllogaritur nga Komisioni sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar tek INSTAT, në vlerën 136.620 lekë, është i drejtë.

46. Pasi në analizën financiare të kryer në Kolegj u reflektua pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht korrektimit të rezultatit negativ të konkluduar prej Komisionit, mbetet gjithsesi me një balancë negative në vitin 2008, duke u kualifikuar kjo situatë faktike sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të papabazuara.

47. Trupi gjykues mori në shqyrtim shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe në deklaratet periodike të interesave, ka pasqyruar të njëjtën adresë që figuron në zyrën e gjendjes civile si vendbanim e vendqëndrim, pa pasur si qëllim të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim, por Komisioni nuk ka arsyetuar e provuar “përpyjekjen” për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë, si kriter të kërkuar nga ligji dhe Aneksi i Kushtetutës.*

Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim¹⁹, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, ka deklaruar si adresë banimi lagjen “{***}”, rruga “{***}”, Fier, por nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi, me qira apo në përdorim, në këtë adresë. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët e tij, në periudhën kohore 2011-2017, kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë në një dhomë në apartamentin në bashkëpronësi të prindërve të tij, i ndodhur në adresën e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ka përdorur dhe

¹⁸ Në pyetësorin e dytë, drejtuar subjektit të rivlerësimit nga Komisioni.

¹⁹ Paragrafët 36.1 - 36.7 e vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

garazhin në bashkëpronësi të prindërve të tij, i ndodhur në të njëjtin objekt me apartamentin. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar pasuritë në përdorim nga ana e tij në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe, si rrjedhojë, nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me pasuritë në përdorim të tij²⁰.

48. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij në lidhje me këtë konkluzion të arritur nga Komisioni, duke argumentuar se në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe në deklaratimet periodike të pasurisë, ai ka deklaruar të njëjtën adresë që figuron në zyrën e gjendjes civile si vendbanim e vendqëndrim, duke nënkuptuar logjikisht se duke banuar në një banesë që nuk është në pronësinë e tij, ai patjetër e përdor atë banesë, në kushtet kur nuk ka deklaruar asnjë banesë me qira apo ndonjë detyrim tjetër. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në përdorim në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka parashtruar se ka ardhur si pasojë e mungesës së vëmendjes nga ana e tij, por gjatë hetimit administrativ ai ka paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm për pasuritë në përdorim dhe burimin e të ardhurave të prindërve të tij për krijimin e tyre. Subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk e ka vlerësuar “përpjekjen” si në elementet objektive dhe ato subjektive, si kriter të kërkuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Nga ana objektive, subjekti ka deklaruar adresën e banimit në banesën e prindërve të tij, që në momentin kur ka filluar të banojë në të e jo në momentin e kalimit të pronësisë, ndërsa nga ana subjektive deklarimet vjetore, shpjegimet në vitin 2014 në ILDKPKI, duhet të vlerësohen si veprime që kanë pasqyruar të vërtetën, pa pasur si qëllim fshehjen apo deklarimin e pasaktë të pasurisë.
49. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar adresë regjistrimi në gjendjen civile dhe adresë banimi: “Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Fier, Bashkia Fier.” Në vijim, në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi, në posedim apo në përdorim, që të ndodhen në këtë adresë. Arsyen e deklarimit të adresës së sipërcituar si adresë banimi e regjistrimi në gjendjen civile, subjekti i rivlerësimit e ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ, ashtu siç është pasqyruar edhe në vendimin e Komisionit, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga ky i fundit. Në lidhje me kohën se kur ka filluar të banojë në apartamentin në bashkëpronësi të prindërve të tij, subjekti ka deklaruar²¹ se ai së bashku me familjen e tij dhe prindërit kanë filluar të banojnë në këtë apartament në periudhën prill - maj 2010.
50. Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, të dorëzuara në vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se në deklaratat periodike të interesave në vitet 2010 – 2016, ka deklaruar si adresë banimi: “lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Fier”, në përputhje me kohën e fillimit të banimit në këtë apartament të familjes dhe prindërve të tij. Sipas të dhënave të përcjella në Komision nga ZVRPP Fier²², në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë të regjistruara pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit apartament me sipërfaqe 170 m², e papajisur me certifikatë pronësie dhe pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit bodrum me sipërfaqe 22 m², e papajisur me certifikatë pronësie. Këto pasuri janë regjistruar në emër të bashkëpronarëve Jaupaj, prindërve të subjektit të rivlerësimit, më datë 26.06.2012.

²⁰ Paragrafi 49.1 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

²¹ Përgjigjja e pyetjes nr. 12 të drejtuar nga Komisioni, në përgjigjet e dërguara nga subjekti në Komision dhe të protokolluara nga ky i fundit me nr. {***} prot., datë 01.03.2019.

²² Të dhënat e cituara janë përcjellë në Komision nga ZVRPP Fier, me shkresat nr. {***} prot., datë 24.04.2018, nr. {***} prot., datë 02.08.2018, dhe nr. {***} prot., datë 01.03.2019.

Ujësjetllës Kanalizime ShA Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2019, i konfirmon Komisionit ekzistencën e kontratës nr. {***}, datë 28.06.2010, e lidhur mes z. M. J dhe shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime ShA Fier.

51. Në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me situatën faktike të cituar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Formulari i deklarimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar ndërr vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

52. Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të deklaronte pasuritë në përdorim, si dhe burimet e krijimit të tyre. Parashikimi i pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës²³, i referuar nga subjekti në argumentim të pretendimit të tij se nuk është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim të tij, në vlerësim të trupit gjykues është një parashikim i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me elementet përbërëse të fshehjes së pasurisë dhe të deklarimit të rremë për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas të cilit përcaktohet si fshehje apo deklarim i rremë çdo deklarim i subjektit të rivlerësimit që tenton të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit, rezultat që do të ishte i kundërt nëse do të bazohej në të dhënat e faktet e vërteta. Ky parashikim kushtetues është reflektuar në përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nuk e ka ngarkuar atë me përgjegjësi për fshehje të pasurive në përdorim të tij, por për pasaktësi në deklarimin e tyre, përgjegjësi kjo e parashikuar në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e cila përcakton: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”.

53. Deklarimi nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike të interesave, i adresës së banimit, adresë e pasurisë në përdorim të tij, i shërben argumentit se nuk gjenden elemente të fshehjes së pasurisë në përdorim, për sa kohë që ky deklarim i ka dhënë mundësi ILDKPKI-së dhe Komisionit të identifikojnë marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri dhe të hetojnë në

²³ Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

lidhje me të, por në kuptim të një deklarami të saktë e të plotë, pasuritë apartament dhe bodrum në lagjen “{***}” në Fier, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, duhet të ishin deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Vetëm deklarimi i adresës së apartamentit në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, si adresë banimi e subjektit, nuk mund të zëvendësojë deklarimin e saktë e të plotë të pasurive në përdorim prej tij, pasi në rastin konkret, apartamenti nuk ishte e vetmja pasuri në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Deklarimi i saktë e i plotë do të përfshinte dhe deklarimin e përdorimit të bodrumit, si dhe burimet e krijimit të këtyre pasurive.

54. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, pretendimet e tij nuk janë të bazuara në ligj.
55. Në shqyrtim të shkakut të ankimit, sipas të cilit, *Komisioni, në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial, nuk ka zbatuar drejt ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, pasi ka zbatuar ndryshimet e këtij ligji, të cilat kanë hyrë në fuqi më vonë se sa koha e kryerjes së veprimeve nga babai i subjektit, duke i dhënë kështu ligjit fuqi prapavepruese e, për pasojë, subjekti nuk është në kushtet e përfitimit të trajtimit preferencial*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim²⁴, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial lidhur me pasuritë në përdorim, apartament 170 m² dhe bodrum 22 m², në lagjen “{***}” Fier, në pronësi të prindërve të tij, në kundërshtim me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
56. Në këtë përfundim, Komisioni ka arritur pasi ka analizuar situatën faktike si vijon.

56.1 Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP-ja Fier, nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë së patundshme (apartament + bodrum) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2012, z. M. J [babai i subjektit të rivlerësimit] ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, një apartament banimi me sipërfaqe ndërtimore 170 m² për vlerën 3.600.000 lekë dhe bodrum me sipërfaqe ndërtimore 22 m² për vlerën 400.000 lekë, në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në lagjen “{***}”, rr. “{***}”, Fier. Referuar nenit 2 të saj, çmimi i pasurive është likuiduar plotësisht nga ana e blerësit me para në dorë, jashtë zyrës së noterisë, në datën e nënshkrimit të kontratës, para redaktimit të saj te noteri publik. Këto pasuri janë regjistruar në ZVRPP-në Fier në emër të z. M. dhe znj. A. J. [prindërit e subjektit të rivlerësimit]. Në datën 05.07.2012, është bërë rivlerësimi i këtyre pasurive, nga ku çmimi i apartamentit është rivlerësuar në vlerën 9.945.000 lekë dhe çmimi i bodrumit është rivlerësuar në vlerën 900.900 lekë.

56.2 Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar si adresë banimi që prej vitit 2010, pikërisht adresën e apartamentit të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, bazuar në të dhënat e pasqyruara në librezat dhe kontratat e lidhura nga babai i subjektit të rivlerësimit me OShEE-në dhe UK Fier, si dhe në deklaramet e vetë subjektit gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve, Komisionit i ka rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë filluar të banojnë në këtë apartament që prej vitit 2010.

²⁴ Paragrafët 36.9 - 36.12.1 të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

56.3 Shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për informacion²⁵, me shkresën e datës 04.03.2019, ka deklaruar se me shtetasin M. J nuk ka pasur kontratë sipërmarrjeje/prenotimi, por vetëm kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2012. Sipas shoqërisë, nuk ka dokumentacion për kohën se kur i janë vënë në dispozicion pasuritë z. Jaupaj, por nga konsultimi me punonjësit e saj, ato janë dorëzuar brenda 6-mujorit të parë të vitit 2010, në një kohë që punimet tërësore në pallat nuk kishin përfunduar akoma. Një pjesë e mirë e materialeve të punimeve të brendshme i ka përballuar me shpenzimet e tij z. M. J, të cilat janë mbajtur parasysh në llogaritjen e çmimit të apartamentit. Mënyra e kryerjes së pagesës ka qenë me para në dorë.

56.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2019, ka përcjellë në Komision vendimin nr. 665, datë 21.04.2009, për çështjen gjyqësore civile me paditës z. A. K., palë e paditur Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Fier, ndërhyrës dytësor z. A. K., persona të tretë shoqëria “{***}” ShPK, znj. A. O dhe z. B. Z, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 28.03.2008, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Fier “Për miratimin e sheshit të ndërtimit” dhe të vendimit nr. {***}, datë 10.06.2008, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Fier “Për dhënien e lejes së ndërtimit”. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues. Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 13.12.2011, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 21.04.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 15.03.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 13.12.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

56.5 Komisioni, duke konstatuar se apartamenti dhe bodrumi i blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit ndodhen pikërisht në godinën e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor në çështjen e sipërcituar, si dhe duke konstatuar se çmimi i blerjes së pasurive nga babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë më i ulët se çmimi mesatar i shitjes lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme për qytetin e Fierit, i cili ka qenë në vlerën 56.094 lekë, sipas udhëzimit nr. 3, datë 03.02.2010, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, i ka kërkuar ILDKPKI-së të japë vlerësimin nëse nga situata e mësipërme, subjekti i rivlerësimit gjendet ose jo në ndonjë nga format e konfliktit të interesit, parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. ILDKPKI²⁶ ka vlerësuar se në lidhje me vendimmarrjen e kësaj çështjeje, nuk rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

²⁵ Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2019, i kërkoj shoqërisë “{***}” ShPK të konfirmojë nëse mes shoqërisë dhe z. M. J ka pasur kontratë sipërmarrjeje/prenotimi, lidhur me këto dy pasuri; kohën kur i janë dorëzuar këto dy pasuri z. M. J dhe a është mbajtur procesverbal dorëzimi; mënyrën e kryerjes së pagesës (cash apo përmes bankës) për blerjen e këtyre dy pasurive, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës; si dhe çdo të dhënë dhe dokumentacion tjetër që kjo shoqëri disponon lidhur me marrëdhënien me z. M. J.

²⁶ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.03.2019, ka përcjellë vlerësimin e saj në Komision, sipas të cilit: “Rezulton se vetë zyrtari/gjyqtari në fjalë nuk ka një marrëdhënie juridike civile të drejtpërdrejtë me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe vlen të theksohet se nga dokumentacioni i paraqitur për subjektin e rivlerësimit Roland Jaupaj, marrëdhëniet juridiko-civile të krijuara midis palëve kanë ndodhur në vitin 2010, pra një vit më vonë nga gjykimi dhe dhënia e vendimit gjyqësor, datë 21.04.2009 [...] dhe nuk mund të provohet ekzistenca e interesit të zyrtarit/gjyqtarit dhe shfaqja e këtij interesi të tërthortë në gjykimin dhe dhënien e këtij vendimi gjyqësor. [...] Nuk mund të vlerësohet dot nëse zyrtari/gjyqtar Roland Jaupaj ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e kësaj çështjeje, si dhe në vendimmarrjen gjyqësore, pra, nëse gjendemi para një “konflikti faktik të interesit”, si dhe një nga llojet e “konfliktit rast për rast të interesit”. Nuk rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, në lidhje me vendimmarrjen e kësaj çështjeje, gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.

57. Në analizë të të dhënave të mësipërme, Komisioni ka arsyetuar se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur trajtim preferencial në marrëdhënien me shoqërinë “{***}” ShPK, pasi:
- (i) ka përdorur pasurinë e kësaj shoqërie për rreth dy vjet pa pasur ndonjë dokument shkresor apo kontratë të lidhur me shoqërinë, si edhe pa kryer ndonjë pagesë për shoqërinë;
 - (ii) ka pasur garanci të plota për përfitimin e kësaj pasurie 2 vjet përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, pasi sipas vetëdeklarimit, gjatë kësaj periudhe ka kryer investime në vlera të konsiderueshme në këtë apartament;
 - (iii) çmimi i shitjes së apartamentit dhe bodrumit/garazhit është dukshëm më i ulët se vlera e tregut.

Komisioni, bazuar në këtë arsyetim, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial lidhur me këto pasuri, në kundërshtim me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

58. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në vijim të qëndrimit të tij të parashtruar edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të depozituara prej tij në Komision, ka pretenduar se babai i tij nuk ka pasur trajtim preferencial në lidhje me kontratat e shitblerjes me shoqërinë “{***}” ShPK. Moskryerja e asnjë pagese për rreth 2 vjet, justifikohet me faktin se pjesën që banorë të tjerë të pallatit e paguanin si parapagim, babai i tij e ka paguar në formën e kryerjes së punimeve me shpenzimet e tij. Garancia për përfitimin e kësaj pasurie ka ardhur si pasojë e kryerjes së investimit dhe faktit se familja e tij gjatë kësaj periudhe banonte në këtë banesë. Çmimi i shitjes së apartamentit dhe bodrumit/garazhit nuk vlerësohen prej subjektit si dukshëm më të ulët se vlera e tregut, por më se normale në rrethanat kur rreth 50 m² e apartamentit janë verandë e hapur e pambuluar, çmimi i së cilës është sa ¼ e çmimit të sipërfaqes së brendshme të apartamentit, si dhe një pjesë e punimeve të brendshme janë bërë me shpenzimet e babait të tij, në vlerën 1.700.000 lekë, vlerë e cila është bërë zbritje nga pagesa e blerjes së banesës. Duke marrë parasysh dhe sa më sipër, çmimi i shitjes është i njëjtë me ato të kontratave të lidhura nga banorë të tjerë të të njëjtit pallat, që nuk i kanë bërë një pjesë të punimeve me shpenzimet e tyre dhe nuk kanë sipërfaqe të pambuluar. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur trajtim preferencial për babain e tij apo familjen e tij, pasi ai as që ka qenë në dijeni të marrëdhënies së babait të tij me shoqërinë “{***}” ShPK dhe njëkohësisht prindërit e tij kanë qenë në padijeni të plotë të faktit se rreth një vit më parë ai kishte qenë anëtar në përbërje të trupit gjykues, në një çështje civile ku palë e paditur ishte shoqëria “{***}i” ShPK. Sipas subjektit, nuk gjendet në kushtet e neneve 23, pika 1 e 24, pika 2 e ligjit nr. 9367/2005, pasi vërtetohet katërçipërisht se ai nuk ka kërkuar ose marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i janë dhënë për shkak të pozicionit, nga një individ, person fizik ose juridik, privat. Po kështu, prindërit e tij nuk janë në kushtet që në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, të luajnë rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim, pasi nuk kanë pasur dijeni që subjekti kishte gjykuar rreth një vit më parë një çështje si anëtar i trupit gjykues me shoqërinë “{***}” ShPK. Subjekti ka parashtruar se veprimet e kryera nga prindërit e tij për marrjen në përdorim e në pronësi të pasurive, janë kryer në periudhën fillim i vitit 2010 deri në qershor/korrik 2012, për pasojë, sipas ligjit në fuqi në atë kohë, që subjekti të ishte në kushtet e trajtimit preferencial, duhet që veprimet e kryera prej tij apo personave të lidhur të shkaktonin lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji. Duke qenë se Komisioni ka pranuar se subjekti dhe personat e lidhur me të, në kohën e kryerjes së veprimeve për blerjen e apartamentit dhe garazhit, nuk kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas ligjit të kohës, atëherë ai nuk duhet të ketë qenë as në kushtet e trajtimit preferencial. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka zbatuar ndryshimet e ligjit të miratuara më vonë në kohë sesa koha e kryerjes së veprimeve nga personat e lidhur me të, duke i dhënë këtij ligji fuqi prapavepruese, në kundërshtim me parimin kushtetues të sigurisë juridike.

59. Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me përmbajtjen e dokumentacionit të paraqitur prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se në raport me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, blerja e pasurive apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum/garazh nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, nuk prodhon gjendjen e subjektit në situatën e trajtimit preferencial. Në rastin konkret, rrethana faktike e cila përcakton legjislacionin e zbatueshëm është data 21.06.2012, datë e lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë së patundshme (apartament + bodrum), në të cilën palët kanë deklaruar se çmimi është likuiduar plotësisht, jashtë zyrës së noterisë, përpara redaktimit të kësaj kontrate. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se legjislacioni i zbatueshëm është ligji i kohës, nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006²⁷, ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006²⁸ dhe ligjin nr. 9690, datë 05.03.2007²⁹. Parashikimet e këtij ligji, ndalimin e marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, e renditin si një nga rastet e kufizime të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta, duke parashikuar në pikën 1 të nenit 23 se: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”. Ndërsa, në pikat 1 dhe 3 të nenit 24 parashikohet se: “1. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21, pikat 1, 2 e 6 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es. [...] 3. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni”.
- Sipas nenit 3, shkronja “ç” e po këtij ligji, konflikti rast për rasti i interesit përkufizohet si gjendja në konflikt interesi faktik, në dukje apo të mundshëm, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë. Bazuar në këtë përkufizim, si edhe në përmbajtjen e neneve 23 dhe 24 të cituara më sipër, rezulton se në lidhje me evidentimin e konfliktit rast për rast të interesit, janë të rëndësishme dy çështje kryesore:
- a) duhet të ekzistojë shfaqja e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, në dukje apo të mundshëm;
 - b) konflikti rast për rast është i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, është i lidhur me vendimmarrjeje konkrete dhe rolin e zyrtarit në këtë vendimmarrje.
- Në çdo rast, konflikti rast për rast i interesit, sipas këtyre parashikimeve ligjore, duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit, e lidhur me një vendimmarrje të caktuar, pra, që vendimmarrja e zyrtarit të jetë e ndikuar nga interesi i tij privat, i lidhur me këtë vendimmarrje. Për sa i përket ndalimit të marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimeve preferenciale, si një nga rastet e kufizimit të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta, thelbi mbetet ndalimi i marrjes së tyre, nëse kjo çon në lindjen e një konflikti qoftë dhe në dukje të interesit. Në konkluzion, sipas legjislacionit të kohës, trajtimi preferencial i zyrtarit ka qenë i lidhur pazgjidhshmërisht me lindjen e konfliktit të interesit.
60. Në rastin konkret, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar, rrethanat faktike në të cilat ndodhej babai i subjektit të rivlerësimit në raport me pasuritë në përdorim të subjektit të

²⁷ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, datë 09.03.2006.

²⁸ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56, datë 08.06.2006.

²⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 16.03.2007.

rivlerësimit, që të vishen me elementet e trajtimit preferencial, duhet të kishin prodhuar lindjen e një konflikti, qoftë dhe në dukje të interesit.

Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 21.04.2009, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, objekti i të cilit lidhet me ndërtimin e pallatit në lagjen “{***}”, Fier, pjesë e të cilit është apartamenti dhe bodrumi në pronësi të prindërve të tij. Nga situata faktike si më sipër, rezulton se marrëdhëniet juridike civile mes babait të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë kanë filluar që në vitin 2010, pra një vit më vonë nga gjykimi dhe dhënia e vendimit gjyqësor të sipërcituar. Komisioni nuk ka arritur të provojë nëpërmjet hetimit administrativ se marrëdhënia e babait të subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK ka filluar dhe/ose ka vazhduar në kohën e gjykimit të çështjes gjyqësore të sipërcituar nga subjekti i rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të provohet ekzistenca e interesit privat të subjektit të rivlerësimit dhe shfaqja e këtij interesi gjatë gjykimit dhe dhënies së vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 21.04.2009, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK. Për pasojë, nuk mund të provohet lidhja mes marrëdhënies juridike të krijuar mes babait të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen gjyqësore në fjalë, në mënyrë të tillë që kjo vendimmarrje të ketë qenë e ndikuar nga interesi i tij privat, në kuptim të neneve 21, pika 1 dhe 24, pikat 1 dhe 3 të ligjit të kohës nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

61. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka përfituar trajtim preferencial lidhur me pasuritë në përdorim të tij, duke e mbështetur arsyetimin në pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit³⁰. Përmbajtja e nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, e cila është referuar nga Komisioni në zgjidhjen e çështjes, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 86/2012, datë 18.09.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar”³¹. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, ndalimi i kërkitimit ose marrjes së dhuratës, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, nuk lidhet domosdoshmërisht me mundësinë e krijimit të konfliktit të interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar atë gjendje.

Komisioni, në rastin konkret, ka zbatuar një dispozitë e cila nuk ka qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit nr. {***}, datë 21.04.2009, nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhe as në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike civile mes babait të tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK në periudhën nga viti 2010 deri në qershor 2012. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk ka identifikuar saktë normën ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, e cila lidhet me momentin e lindjes së marrëdhënies objekt shqyrtimi në raport me momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 86/2012, datë 18.09.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar”.

Identifikimi i gabuar i dispozitës ligjore, i cili nuk mbështetet në ligjin e kohës të zbatueshëm në rastin konkret, e bën të gabuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial, për pasojë ky konkluzion është i pabazuar në ligj.

³⁰ Në shënimin 43 në fund të faqes 21 të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, Komisioni ka referuar përmbajtjen e nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, duke cituar: “Pika 1 e nenit 23, e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: “[...] është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”.

³¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 11.10.2012.

62. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, se çmimi i shitjes së apartamentit dhe bodrumit/garazhit është dukshëm më i ulët se vlera e tregut, ishte i panevojshëm për zgjidhjen e çështjes.
63. Trupi gjykues çmon të theksojë se nëse Komisioni do të kishte identifikuar dispozitën e duhur ligjore, pavarësisht konkluzionit lidhur me mungesën e kushteve për të pasur një trajtim preferencial sipas legjislacionit të kohës, rrethanat faktike të provuara gjatë hetimit administrativ, se rreth një vit përpara hyrjes së babait të subjektit të rivlerësimit në marrëdhënie juridike civile me shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje në të cilën kjo shoqëri ka qenë palë e tretë dhe objekt i shqyrtimit gjyqësor ka qenë godina, në të cilën ndodhen apartamenti dhe bodrumi i blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, përdorimi i kësaj banese dhe garazhit nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij për rreth dy vjet, pa pasur një akt formal shitblerjeje dhe pa kryer asnjë pagesë ndaj shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, do të duhej t’i kishte kualifikuar, brenda qëllimit dhe objektit të procesit të rivlerësimit, në përputhje me përgjegjësinë e gjyqtarëve që dhe në jetën e përditshme të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor e besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, si dhe me detyrimin e tyre që veprimet jashtëgjyqësore të jenë të atilla që të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tyre, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore³².
64. Në shqyrtim të shkakut të ankimit sipas të cilit, *konkluzioni i Komisionit se personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2012, pasuri këto në përdorim të subjektit të rivlerësimit, është i pabazuar në prova, pasi Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe kursimet e mundshme të krijuara prej tyre në vite*, trupi gjykues vëren se në vendim, Komisioni ka arsyetuar se nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përdorur dhe vazhdon të përdorë pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum/garazh me sipërfaqe 22 m² në pronësi të prindërve të tij, referuar pikës 14 të nenit 3 dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit të rivlerësimit bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Komisioni ka kryer analizën e treguesve financiarë të prindërve të subjektit, për periudhën 1996-2012, për të vlerësuar mundësinë e krijimit të pasurive të sipërcituara. Nga rezultati i analizës financiare, Komisioni ka arritur në përfundimin se personat e tjerë të lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive deri në fund të vitit 2012, duke e renditur këtë përfundim në shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit.
65. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim pretendimet e tij në raport me konkluzionin e Komisionit, duke kontestuar rezultatin e analizës financiare, me pretendimin se nuk janë përlllogaritur të ardhurat e babait të tij në vlerën 600.000 lekë - 700.000 lekë në vit, për periudhën nëntor 1993 - dhjetor 2002, kur babai i tij ka punuar si tregtar ambulant në tregun e Fierit. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji që këto të ardhura të vlerësohen të ligjshme, sepse:
- sipas përgjigjes që i ka kthyer Bashkia Fier me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 14.05.2019, tregtarët ambulantë nuk kanë pasur detyrimin të regjistrohen në bashki në periudhën 1993-2002, kur ka ushtruar aktivitetin si tregtar ambulant babai i subjektit;

³² *Parimet e Bangalores, miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23, komentet nr. 111-114: http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf dhe rregullat e Kodit të Etikës, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare më datë 08.12.2006: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf*

- babai i tij është në pamundësi objektive, parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, e vërtetuar kjo pamundësi me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2009, të Bashkisë Fier;

- ai ka paraqitur prova si deklaratat noteriale të babait të tij, si edhe të shtetasve L. K, Th. B e Y. D për ushtrimin e aktivitetit si ambulant nga babai i tij.

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu se Komisioni, në burimet e ligjshme financiare të prindërve të tij, duhet të kishte përfshirë të ardhurat e siguruara nga ata, si:

- të ardhurat e nënës së tij për periudhën 01.09.1973 - 31.12.1995;

- të ardhurat e babait të tij për periudhën 28.12.1969 - 16.10.1993, punësuar me pagë mesatare neto 12.171 lekë/muaj;

- të ardhurat e babait të tij për periudhën 16.10.1993 - 31.12.1995, asistencë me pagesë për gjithë këtë periudhë, në vlerën 155.290 lekë;

- kursimet nga të ardhurat nga puna e prindërve të tij deri në dhjetor 2002, mbi bazën e pagës sipas koeficientit të përlllogaritur nga DRSSH Fier.

66. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga babai i tij nga ushtrimi i aktivitetit tregtar ambulant për periudhën nëntor 1993 - dhjetor 2002, ka arsyetuar në vendim³³: “[...] nuk do të merren në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me të ardhura të realizuara nga babai i tij për periudhën 1993 – dhjetor 2002 nga aktiviteti i pretenduar si ambulant, pasi kanë karakter deklarativ dhe nuk janë të bazuara në dokumentacion provues ligjor për vlerën dhe kohën e krijimit të këtyre të ardhurave të pretenduara, si dhe pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore”.

Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, vëren se subjekti i rivlerësimit për të provuar faktin se babai i tij ka qenë tregtar ambulant, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2019, të z. M. J [babai i subjektit të rivlerësimit], i cili deklaron se pasi është liruar nga detyra si oficer, gjatë periudhës nëntor 1993 - dhjetor 2002, ka ushtruar aktivitetin e tregtarit ambulant në tregun ambulant të artikujve të ndryshëm të qytetit të Fierit, periudhë gjatë së cilës ka realizuar fitim vjetor mesatar, në masën 600.000 - 700.000 lekë në vit. Me të njëjtin qëllim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dy deklarata noteriale³⁴ të hartuara nga individë, të cilët deklarojnë se në të njëjtën kohë që ata kanë ushtruar aktivitetin si tregtarë ambulantë në tregun ambulant të qytetit të Fierit, ka ushtruar të njëjtin aktivitet edhe z. M. J. Bashkia Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.03.2019, ka informuar Komisionin se nga verifikimet e kryera në sistemin TAIS³⁵, në të cilin regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi në Bashkinë Fier, nuk figurojnë të dhëna për shtetasin M. J, kurse Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.05.2018, ka përcjellë në Komision informacionin se z. M. J nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar.

67. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vërtetësia e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga babai i tij në vitet 1993-2002, provohet nga përgjigjja që Bashkia Fier i ka kthyer atij, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2019, në të cilën sqaron se: *Sistemi TAIS ku regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi pranë Bashkisë Fier është në funksion nga viti 2016 e përfshin të dhëna nga ky vit. Drejtoria e Taksave e Tarifave, pranë Bashkisë Fier, nuk ka Arkiv e nuk ka Regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave për vitet 1993-2002. Tregtarët ambulantë nuk kanë pasur detyrim të regjistrohen në Bashki. Kjo shkresë është administruar nga Komisioni, së bashku me shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ.*

³³ Paragrafi 37.10.3 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

³⁴ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2018, e z. L. K dhe z. Th. B dhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2019, e shtetasit Y. D.

³⁵ TAIS – Sistemi i Administrimit të Informacionit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

68. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të babait të tij, si tregtar ambulant në periudhën 1993-2002, arriti në përfundimin se ato nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion, duke arsyetuar si vijon. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion zyrtar që provon ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga babai i tij, por është përpjekur të provojë këtë fakt me deklaratat noteriale të individëve, të cilët pretendohet se kanë ushtruar aktivitetin e ambulantit në të njëjtën kohë me babain e tij. Deklaratat noteriale të z. L. K., z. Th. B e z. Y D, në një qëndrim tejet garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mund të provojnë faktin se babai i tij ka zhvilluar aktivitet tregtar ambulant në periudhën e pretenduar, por nuk mund të provojnë kurrësi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij në vlerën mesatare 600000 -700000 lekë në vit. Deklarata noteriale e z. M. J, e pashoqëruar me dokumentacion zyrtar nga organet kompetente, për nga vlera provuese është e barabartë me deklaratat e subjektit të rivlerësimit.
69. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se babai i tij është në pamundësi objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, e vërtetuar kjo pamundësi me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2009, të Bashkisë Fier, trupi gjykues vlerëson se nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes, pasi edhe sikur të kishte arkiv dhe regjistër për regjistrimin e taksave për periudhën 1993-2002 në Bashkinë Fier, përsëri nuk do të mund të përlllogaritej sa ka qenë fitimi i realizuar nga babai i subjektit në këtë periudhë dhe, për rrjedhojë, nuk do të mund të provohesh shumën e pretenduar prej tij si fitim vjetor.
- Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga babai i tij për periudhën nëntor 1993 – dhjetor 2002 kanë qenë në masën 600.000 - 700.000 lekë në vit, për pasojë, vlerësimi i Komisionit për të mos i konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të pasurive apartament 170 m² dhe bodrum 22 m² në vitin 2012, në pronësi të babait të tij dhe në përdorim të tij, është i drejtë.
70. Në shqyrtim të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se në burimet e ligjshme financiare të prindërve të tij, Komisioni duhet të kishte përfshirë të ardhurat e siguruar nga puna e tyre, si dhe kursimet e realizuara në vite, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka mbështetur pretendimet e tij në dokumentacionin e paraqitur në Komision gjatë hetimit administrativ³⁶.
- Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, rezulton se në vërtetimin nr. {***} prot., datë 16.10.2018, të DRSSH³⁷ Fier janë pasqyruar pagat referuese për efekt të përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë për znj. A. J, sipas pozicioneve të punës për periudhën 01.09.1973 - 31.12.1993, të shumëzuara me koeficientin përkatës, por jo pagat bruto dhe neto të përfituara në fakt. Vërtetimit i është bashkëlidhur informacioni nga komuna {***}, me pasqyrat për pagat bruto dhe neto të përfituara në fakt, duke filluar nga korriku i vitit 1995 deri në vitin 2011, ndërsa për periudhën janar 1994 - korrik 1995 janë paraqitur të dhënat vetëm për pagën bruto dhe jo neto që ka përfutuar znj. J. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i sipërcituar provon faktin se znj. A. J ka qenë në marrëdhënie pune në periudhën 01.09.1973 - 31.12.1993, për të cilën janë paguar kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, por pagat e pasqyruara janë paga referuese e pozicionit për efekt të përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë, të cilat nuk referojnë vlerën reale të pagës së përfutuar nga znj. J., mbi të cilën të mund të përlllogariten kursimet e mundshme të familjes Jaupaj në këtë periudhë. Në lidhje me pagat e përfituara nga znj. J në periudhën korrik 1995 - prill 2011³⁸, trupi gjykues konstaton

³⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të dytë, të protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 01.03.2019.

³⁷ Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

³⁸ Në muajin prill 2011, znj. A. J ka filluar të përfutojë pension pleqërie.

se Komisioni nuk ka përllogaritur vetëm pagat për periudhën korrik - dhjetor 1995, ndërsa të ardhurat për periudhën janar 1996 - prill 2011 janë përllogaritur si të ardhura të përfituara nga znj. J. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat për periudhën korrik - dhjetor 1995, në vlerën 44.381 lekë, duhet të ishin përllogaritur nga Komisioni si të ardhura të znj. J, për rrjedhojë i ka konsideruar ato në analizën financiare të kryer në Kolegj.

Në lidhje me të ardhurat e z. M. J, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e DRSSH Fier nr. {***}prot., datë 16.10.2018, ku janë përshkruar funksionet e karrierës si ushtarak për periudhën 28.12.1969 - 16.10.1993, si edhe pagat referuese për efekt të llogaritjes së pensionit të pleqërisë. Në kushtet kur ky dokumentacion nuk përmban informacion për pagën neto të përfituar, në fakt, nga babai i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim si dhe Komisioni, duke mos i konsideruar ato në zërin e të ardhurave.

71. Subjekti i rivlerësimit, pretendimet e tij për përllogaritjen e të ardhurave të prindërve i ka lidhur ngushtësisht me pretendimin e përllogaritjes nga Kolegji të mundësisë së kursimeve të krijuara nga këto të ardhura, mbi bazën e pagës sipas koeficientit të përllogaritur nga DRSSH Fier, pasi ai pretendon se është e pamundur që prindërit e tij të mos kishin krijuar kursime në periudhën që ata kanë qenë në marrëdhënie pune.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se kursimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të përllogariten mbi paga joreale, pasi ky kursim nuk do të ishte në asnjë rast kursimi real i prindërve të tij për periudhën e pretenduar, duke prodhuar kështu një rezultat të deformuar për efekt të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues thekson, gjithashtu, se të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare³⁹. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se kursimet e prindërve të tij në periudhat para viteve '90, mund të ishin përdorur prej tyre apo mund të kishin ndikuar në blerjen e pasurive në vitin 2012, nuk është i besueshëm.

72. Referuar analizës financiare të kryer në Kolegj, mbi bazën e arsyetimit të mësipërm, ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit, me gjithë korrektimin e situatës negative financiare të rezultuar nga Komisioni, kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për krijimin e pasurive apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum me sipërfaqe 22 m², pasuri këto të ndodhura në përdorim të tij, në vlerën 1.459.398 lekë.

73. Pavarësisht këtij arsytimi, i cili ishte i kushtëzuar nga nevoja për t'u dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerëson se është detyrë e tij të identifikojë kryesisht, se cila është norma juridike e zbatueshme në analizimin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me pasuritë në përdorim të tij, pasuri në pronësi të prindërve të tij dhe nëse për shkak të kësaj marrëdhënieje, prindërit e tij mund të konsiderohen persona të tjerë të lidhur me të, ashtu siç i ka konsideruar Komisioni në arsyetimin e tij, duke i vendosur për këtë arsye subjektit të rivlerësimit detyrimin për të shpjeguar burimin e ligjshëm të pasurive të sipërcituara.

74. Në vlerësimin e trupit gjykues, kualifikimi i prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur nuk është i drejtë, në raport me natyrën dhe objektin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me pasuritë në pronësi të tyre.

Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/201614, që një person fizik ose juridik të konsiderohet si "person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit", duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: i) një interes pasuror; ose ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Përkufizimi i marrëdhënies së biznesit gjendet në radhën e

³⁹ Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 1993:

https://www.bankofalbania.org/Botime/Botimet_sipas_viteve/Raporti_Vjetor_1993.html

përkufizimeve të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 9 të tij. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror⁴⁰. Pra, interesi pasuror duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe një personi fizik ose juridik. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, subjekti i rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të dhurimit apo huas. Ky detyrim ligjor që i përket subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të cenohet apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni apo Kolegji për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

75. Referuar interpretimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se vetëm fakti që subjekti i rivlerësimit edhe pse ka krijuar familjen e tij vazhdon të jetojë ende me prindërit dhe për këtë arsye është duke i përdorur pasuritë e tyre, nuk mjafton për të provuar se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij janë në një marrëdhënie interesi pasuror. Në këto kushte, përdorimi i pasurisë së prindërve nga subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara, në kuptim të të cilave të mund të kualifikojë z. M. J dhe znj. A. J si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, t'i ngarkonte ata dhe subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive apartament me sipërfaqe 170 m² dhe garazh/bodrum me sipërfaqe 22 m². Në këto kushte, Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të situatës faktike, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, duke trajtuar si persona të tjerë të lidhur prindërit e subjektit, jo në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e pasurive të paluajtshme në pronësi të prindërve të tij, është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.
76. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se vlerësimi i gabuar i situatës faktike nga Komisioni, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, ka ndikuar në kufizimin e kontrollit të kryer prej tij, vetëm në vlerësimin e mundësisë së prindërve të subjektit për të krijuar pasuritë në fjalë. Trupi gjykues vlerëson se rrethanat e konstatuara e të provuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit në këtë gjykim se:
- (i) babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum/garazh me sipërfaqe 22 m², nga shoqëria “{***}” ShPK, me çmim më të ulët krahasuar me çmimet e tregut në qytetin e Fierit për atë periudhë dhe për një periudhë rreth dyvjeçare i ka poseduar këto pasuri pa pasur një akt formal;
 - (ii) subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues në vendimmarrjen për zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore, objekt gjykimi i së cilës kanë qenë marrëdhënie të lidhura me godinën, pjesë e së cilës janë pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum/garazh me sipërfaqe 22 m², rreth një vit më parë se babai i tij të hynte në marrëdhënie juridike civile për këto pasuri;
 - (iii) subjekti i rivlerësimit ka përdorur pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum/garazh me sipërfaqe 22 m² që nga viti 2010, në të njëjtën kohë që ato kanë filluar të përdoren edhe nga pronarët e tyre [prindërit e tij];

⁴⁰ Sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

(iv) prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për të blerë këto pasuri;

– nuk mund të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit kishte vetëm marrëdhënie përdorimi me këto pasuri, ashtu siç ai ka deklaruar gjatë hetimit administrativ dhe në ankim. Në këto kushte, Komisioni nëse do të kishte kryer një hetim të plotë të situatës faktike dhe nëse do ta kishte interpretuar atë drejt në raport me legjislacionin e zbatueshëm, do duhej të vlerësonte nëse do të ishin kushtet për të arritur në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasuritë, duke qenë se konflikti i interesit nuk ekzistonte [sipas arsytimit të bërë në paragrafët 61-63 të këtij vendimi].

Trupi gjykues vlerëson se vetëm në këtë mënyrë Komisioni do të kishte arritur në një përfundim të drejtë, lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe garazh/bodrum me sipërfaqe 22 m².

77. Në këtë përfundim të trupit gjykues, ndërthuret vlerësimi logjik e i arsyeshëm i të gjitha rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i kryer në Komision me qëndrimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit në trajtimin e çështjeve të ngjashme. Në këtë kontekst, trupi gjykues gjen me vend të theksojë nevojën për të orientuar Komisionin, në përputhje me nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që të ndjekë këtë mënyrë arsytimi në të ardhmen, në drejtim të nevojës për kualifikimet e duhura ligjore të situatave faktike, veçanërisht në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve, në lidhje me cilësimin e personit/personave të tretë, si person/persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, apo të marrëdhënies konkrete të subjekteve të rivlerësimit me pasuritë e caktuara.
78. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, personi i lidhur – bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – ka deklaruar burimin e krijimit dhe ka paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e secilës prej depozitave, si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për të krijuar ato, trupi gjykues vëren se, në lidhje me depozitat bankare si pasuri të deklaruara veçmas, në pronësi 100% të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendim⁴¹ ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e disa depozitave dhe llogarive bankare në emrin e personit të lidhur me të dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive”. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, ai ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur bankar për krijimin e depozitave, si dhe gjatë hetimit administrativ, ai ka shpjeguar burimet e krijimit të depozitave të bashkëshortes së tij, që janë të ardhurat e saj nga puna si mjeke, interesat bankarë, shuma prej 1.000.000 lekësh, dhuruar nga z. S. K e znj. A. K në vitin 2002, si dhe të ardhurat në vlerë 13.000 euro, të realizuara nga marrëveshja për përfaqësim e ndërmjetësim për blerje apartamenti e vitit 2006 me znj. A. K e z. S. K.
79. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ka paraqitur dokumentacionin e duhur bankar për krijimin e depozitave, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, znj. R. J, bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar pasuritë, si vijojnë.
Depozitë aktuale në “Veneto Bank”, dega Fier, më datë 18.01.2017 - 14.01.2019, burimi – nga depozitat bankare të mëparshme prej 783.387 lekësh + përfitimi i interesave. Vlera 800.080 lekë, 100%.

⁴¹ Paragrafi 49.1 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, i Komisionit.

Depozitë aktuale në “Veneto Bank”, dega Fier, më datë 31.08.2015 - 31.08.2018 – nga depozita bankare e mëparshme prej 800.000 lekësh + interesi i përfituar, të lëna sërish në depozitë. Vlera 895.200 lekë, 100%.

Depozitë aktuale në “Veneto Bank”, dega Fier, më datë 29.08.2016 - 29.08.2019, burimi – nga depozita bankare e mëparshme e përfitimi i interesave. Vlera 782.937 lekë, 100%.

Depozitë aktuale në “FI Bank”, dega Fier, më datë 31.08.2015 - 31.08.2017, burimi – nga depozita bankare e mëparshme prej 1.282.000 lekësh e përfitimi i interesave. Vlera 1.482.900 lekë, 100%.

Depozitë aktuale në “IC Bank”, dega Fier, më datë 29.08.2016 - 29.08.2019, burimi – nga depozita bankare e mëparshme prej 1.282.000 lekësh e përfitimi i interesave. Vlera 1.352.957 lekë, 100%.

Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratat përkatëse⁴² të lidhura me institucionet bankare, sipas të cilave janë krijuar depozitat e deklaruara nga bashkëshortja e tij. Trupi gjykues konstaton se në vijim të deklaramit të saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, znj. R. J, ka deklaruar se depozitat bankare aktuale, në vlerë totale 4.594.074 lekë, që ajo i disponon si pasuri veçmas, e kanë origjinën e krijimit nga dy depozita fillestare:

- depozita nr. 000196/01, në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (ICB). Kjo depozitë është çelur në datën 26.08.2009, në shumën 1.800.000 lekë, derdhje cash;

- depozita nr. 000069/02, në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (ICB). Kjo depozitë është çelur në datën 26.08.2009, në shumën 10.000 euro, derdhje cash.

Por bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar burimin fillestar financiar, në kuptimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre. Bazuar në këtë konstatim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30, 31, pika 1, 32, pika 1 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave ai ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, me qëllim që t’i nënshtrohet kontrollit të pasurisë, për të verifikuar nëse ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose nëse i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshortja e tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të depozitave bankare në pronësi të saj.

80. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar duke mos konsideruar si burim krijimi të depozitave të bashkëshortes në vitin 2009, shumën prej 1.000.000 lekësh të dhuruar asaj nga tezja e vet, trupi gjykues vëren se Komisioni, në lidhje me depozitat e deklaruara veçmas nga znj. R. J, ka arsyetuar në vendim⁴³ se: “[...] personi i

⁴² Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këtë dokumentacion:
- kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 18.1.2017, për hapje depozite nga znj. R. J, në vlerën 800.080 lekë; data e mbarimit të afatit 18.1.2019, dhe urdhërpagesë e shumës prej 800.080 lekësh nga znj. R. J, në datën 18.1.2017;

- kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 31.8.2015, për hapje depozite nga znj. R. J, në vlerën 895.200 lekë; data e mbarimit të afatit 31.8.2018;

- kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 29.8.2016, për hapje depozite nga znj. R. J, në vlerën 782.973 lekë; data e mbarimit të afatit 29.8.2019 dhe urdhërpagesë e shumës prej 782.973 lekësh nga znj. R. J, datë 29.8.2016;

- kontratë depozite me “FiBank”, e datës 31.08.2015, për hapje depozite nga znj. R. J, në vlerën 1.482.900 lekë, afati i depozitës 24 muaj; dhe urdhërpagesë e shumës prej 1.482.900 lekësh, nga znj. R. J, datë 31.8.2015;

- kontratë depozite me “Bankën Ndërkombëtare Tregtare”, e datës 29.8.2016, për hapje depozite nga znj. R. J, në vlerën 1.352.957 lekë; afati i depozitës - 36 muaj.

⁴³ Paragrafi 47.7 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

lidhur në deklarin fillstar nuk ka deklaruar si burim krijimi të pasurive vlerën prej 1.000.000 lekësh, të pretenduar si të dhuruar nga teza e saj në vitin 2002. Nisur edhe nga vetëdeklarimet e bëra nga personi i lidhur dhe të z. S. K (bashkëshorti i tezes së saj), Komisioni vlerëson se këto të ardhura kanë shërbyer për shpenzimet e shkollimit të znj. R. J për periudhën 2002-2005. Si rrjedhim, Komisioni çmon se në analizën financiare nuk do të përlllogariten këto të ardhura, si të ardhura të cilat mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të personit të lidhur”.

Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar se në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin është pasqyruar burimi i krijimit të depozitave dhe janë paraqitur provat për të vërtetuar ligjshmërinë e burimit të tyre. Dhurimi i shumës prej 1.000.000 lekësh bashkëshortes së tij nga A. e S. K, është një fakt i vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.10.2014, e z. S. K dhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2018, e znj. R. J dhe fakti se kjo shumë është dhënë për qëllime shkollimi nuk do të thotë se është përdorur totalisht për të. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se në deklarin fillstar në vitin 2010, bashkëshortja e tij nuk e ka deklaruar këtë shumë si burim krijimi të pasurive të saj, pasi ka vlerësuar se diferenca e pashpenzuar e kësaj shume për qëllime shkollimi, është shpenzuar në një masë të madhe për jetesë në vitet 2005-2009 dhe, si pasojë e kësaj, janë kursyer të ardhurat nga paga, të cilat janë përdorur si burim krijimi për depozitat në vitin 2009, respektivisht në masën 1.800.000 lekë dhe 10.000 euro.

81. Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues evidenton situatën faktike në vijim. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si pasuri edhe: “Dhuratë nga z. S. K e znj. A. K, në vitin 2002, për të përballuar ndjekjen e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë Tiranë. Vlera 1.000.000 lekë. Pjesa 100%”.

Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.10.2014, të z. S. K, në të cilën ky i fundit deklaron se: “[...] i kam dhuruar në maj 2002, R., studente në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, mbesës së bashkëshortes sime, shumën prej 1.000.000 lekësh. Kjo shumë parash është fryt i kursimeve prej të ardhurave të punës sime e të bashkëshortes sime në Greqi [...]. Këtë shumë ia kam dhënë në dorë, për të përballuar kryesisht nevojat e arsimit e të shkollimit të saj, blerje librash e mjete mësimore të nevojshme, si dhe për t’i përdorur sipas dëshirës pas përfundimit të studimeve, deri në punësimin e saj. [...] Tepricat e kësaj shume të dhuruar, të përdorura sipas qëllimit të dhurimit, pas përfundimit të shkollës e realizimit të punësimit të saj, janë pasuri e saj e R. mund t’i përdorë për nevojat e saj sipas dëshirës, mund të bëjë çdo lloj veprimi”.

Në deklaratën periodike vjetore të interesave të vitit 2010, i cili ka qenë dhe deklarimi për herë të parë i znj. R. J, në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ajo ka deklaruar si burim krijimi të depozitave bankare në pronësi të saj, të ardhurat nga puna si mjeke (të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet), të ardhurat e përfituara nga marrëveshja e vitit 2006 për blerje apartamenti, si dhe të ardhurat e përfituara nga interesat bankarë. Shumën prej 1.000.000 lekësh, si burim për krijimin e depozitave të bashkëshortes në vitin 2009, subjekti e ka deklaruar për herë të parë në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁴⁴, bashkëlidhur të cilave ka depozituar në Komision dhe deklaratën noteriale të znj. R. J nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2018, në të cilën, lidhur me dhurimin e shumës prej 1.000.000 lekësh nga të afërmit e saj, ajo deklaron: “Në maj të vitit 2002 kam qenë studente në Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Tiranës. Në këtë kohë, për shkak të studimeve, fokusimit vetëm te shkollimi, më është dhuruar në

⁴⁴ Në përgjigjet e pyetësorit të dytë të Komisionit, të protokolluara në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 01.03.2019.

total, nga tezja ime A. K e bashkëshorti i saj S. K, në shenjë të veçantë dashurie të ndërsjellë, shuma prej 1.000.000 lekësh, me qëllim për të përballuar kryesisht nevojat e arsimimit e shkollimit tim, blerje librash e mjetesh mësimore të nevojshme, si dhe për t'i përdorur sipas dëshirës pas përfundimit të shkollës së lartë, deri në punësimin tim. Kjo shumë më është dhënë në dorë. Qëllimin e motivin e kësaj dhurate, unë e kam pranuar, respektuar e zbatuar në maksimumin e mundësive të mia”.

82. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur në deklaratën fillestarë në vitin 2010, nuk ka deklaruar si burim krijimi të depozitave në emër të saj, vlerën prej 1.000.000 lekësh të pretenduar si të dhuruar nga të afërmit e saj në vitin 2002. Edhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 03.12.2018, ajo pranon dhurimin e shumës 1.000.000 lekë nga të afërmit e saj në vitin 2002 për qëllime studimi e jetese derisa të hynte në marrëdhënie pune, por nuk deklaroi se kjo shumë i ka shërbyer si burim krijimi i pasurive të saj në vitin 2009.

Komisioni, në arsyetimin e bërë në vendim, nuk ka mohuar në asnjë moment dhurimin e shumës prej 1.000.000 lekësh bashkëshortes së subjektit nga të afërmit e saj, por ka arsyetuar se kjo shumë i ka shërbyer asaj për shpenzime shkollimi e jetese, në kohën kur ka qenë studente në vitet 2002-2005, arsyetim ky në përputhje të plotë me deklaratat e vetë bashkëshortes së subjektit dhe z. S. K, dhuruesit të shumës prej 1.000.000 lekësh. Komisioni, arsyetimin e tij e ka mbështetur gjithashtu në deklaratën e bërë nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën fillestare të deklaratimit të interesave në vitin 2010, në të cilin nuk ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë si burim krijimi të depozitave.

Për shkak të faktit se bashkëshortja e subjektit nuk e ka pretenduar shumën prej 1.000.000 lekësh si burim të krijimit të depozitave në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përputhje me detyrimin ligjor, por as në deklaratën fillestare të interesave në vitin 2010, e cila, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerë provuese të fakteve të deklaruara në të, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësitë e bashkëshortes së subjektit për financimin e depozitave të krijuara prej saj në vitin 2009. Kjo shumë nuk do të konsiderohet si e tillë as në analizën financiare të kryer në Kolegj për të verifikuar mundësitë financiare të bashkëshortes së subjektit për të krijuar këto pasuri.

83. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka gabuar duke mos konsideruar si burim krijimi të depozitave shumën prej 13.000 eurosh të përfituar nga bashkëshortja e tij, nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim dhe përfaqësim për blerje apartamenti me znj. A. e z. S. K, trupi gjykues vëren se në argumentim të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se arsyeja e kryerjes së veprimeve për blerjen e një apartamenti nga bashkëshortja e tij për llogari e interes të znj. A. e z. S. K, është fakti se ata punonin e jetonin prej vitesh në Greqi dhe midis bashkëshortes e tezes së saj ka pasur një marrëdhënie të veçantë dashurie e besimi reciprok. Midis znj. R. M⁴⁵ [J] dhe znj. A. e z. S. K është lidhur një kontratë verbale përfaqësimi për blerjen e një apartamenti. Me këtë tagër, bashkëshortja e tij ka hyrë në marrëdhënie me z. G. Gj, të cilit me anë të kontratës noteriale nr. {***}rep., nr. {***}kol., datë 26.03.2007, i ka blerë një apartament me sipërfaqe 68,2 m² në Tiranë, në vlerën 52.000 euro. Këtë apartament, z. G. Gj ia ka blerë me anë të kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2007, shoqërisë {***}, për të cilën ka shlyer të gjithë shumën e caktuar, që do të thotë se edhe nëse ka revokuar kontratën me rezervë të shitjes nr. v, datë 23.03.2007, ai më datë 26.03.2007 ka kryer një veprim juridik tjetër që ka fuqi në këtë datë, për të vijuar më pas marrëdhënien me z. R. M., duke lidhur kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 26.03.2007, për shitjen e të njëjtit apartament. Kontrata e shitjes e lidhur mes z. Gj. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, më datë 26.03.2007, vërteton se apartamenti ishte i

⁴⁵ Malaj është mbiemri i vajzërisë i znj. R. J, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

lirë më datë 26.03.2007 dhe nuk ishte blerë nga një i tretë, nga znj. A. K, siç pretendon Komisioni. Znj. A. K nuk ka lidhur një kontratë shitjeje me rezervë më 23.03.2007, siç ka konstatuar Komisioni, pasi nëse ishte kështu, ajo nuk kishte pse të lejonte bashkëshorten e tij të blinte të njëjtin apartament tri ditë më vonë, por edhe siç provohet nga të dhënat e sistemit TIMS, znj. A. K. nuk ka qenë në Shqipëri në këtë datë.

Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që më datë 26.03.2007, apartamenti është blerë nga z. Gj. te shoqëria “{***}” ShPK, vërtetohet nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2013, e znj. J. Gj., bashkëshortja e z. G. Gj., e cila jep pëlqimin për shitjen e bërë nga bashkëshorti i saj te znj. R. M., për apartamentin me sipërfaqe 68,2 m². Subjekti vijon me pretendimet e tij duke parashtruar se bashkëshortja e tij nuk mund t’u shiste znj. A. e z. S. K pasurinë e blerë në interes e për llogari të tyre, me paratë e këtyre të fundit, pra t’u shiste një pronë pronarëve realë të saj. Znj. A. K është vënë në kontakt personalisht me shoqërinë “{***}” ShPK dhe e ka formalizuar veprimin juridik për të blerë apartamentin me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2015, në rrethanat që me znj. R. J nuk mund të kryente veprime ligjore për kalimin e pronësisë së kësaj pasurie, e njëjta për të cilën u lidh kontrata midis z. Gj. e znj. R. M (J.) më datë 26.03.2007. Fakti se çmimi i shitjes së apartamentit në kontratën e lidhur mes znj. A. K dhe shoqërisë “{***}” ShPK ndryshon nga ai i kontratës së lidhur mes znj. R. M. dhe z. G. Gj, nuk ndryshon aspak paktin e çmimit të paguar për këtë të dytin, çmim i paguar nga shuma prej 65.000 eurosh dhënë nga znj. A. e z. S. K për blerje apartamenti, ku diferenca mes shumës 65.000 euro dhe shumës 52.000 euro si çmim i blerjes së apartamentit, përbën fitimin e realizuar nga znj. R. M, prej 13.000 eurosh.

84. Në analizë të ecurisë së fakteve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues verifikoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nga ku rezultoi, si vijon.

84.1 Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Përfitim nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim e përfaqësim për blerje banese për llogari dhe interes të z. S. K dhe znj. A. K, e realizuar në vitin 2007. Vlera 13.000 euro. Pjesa takuese 100%.”

84.2 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Apartament 1+1 blerë në Tiranë, në vitin 2007, nga dhe në emër të R. M. (J) për llogari e interes të shtetasit S. K, i pahipotekuar. Vlera 52.000 euro. Pjesa takuese 100%.”

84.3 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.10.2014, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, z. S. K deklaroi se: “Në verën e vitit 2006, i kam kërkuar R. të blejë për llogari e interesin tim, një apartament në qytetin e Tiranës, pasi unë banoj e punoj në Greqi dhe nuk mund ta kryej vetë këtë veprim. Nuk i kam lënë prokurë për të më përfaqësuar për kryerjen e këtij veprimi, bëmë një marrëveshje verbale, sipas së cilës blerja fillimisht mund të realizohej në emrin e saj, por për llogari e interesin tim dhe më pas do të kryhej procedura për kalimin e pronësisë në emrin tim. [...] Shuma që i kam dhënë znj. R. M për të blerë këtë apartament, është 65.000 euro. Kjo shumë parash i është dhënë në dorë. Në rast se apartamenti i kërkuar do të blihej nga znj. M. në një vlerë më të ulët se ajo që i kam dhënë, diferenca do t’i kalonte asaj në pronësi që në momentin e blerjes së apartamentit të miratuar nga unë, me kusht që të përkujdesej për këtë apartament, deri [...] në kalimin e pronësisë së këtij apartamenti në emrin tim. [...] Në mars të vitit 2007, [...] znj. R. M. ka blerë në emrin e saj me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2007, por për llogarinë time, apartamentin 1+1, me sipërfaqe 68,2 m², i ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë, në vlerën 52.000 euro. Sipas marrëveshjes verbale, edhe diferenca e shumës së dhënë prej meje për blerjen e këtij apartamenti, në vlerën 13.000 euro, i kaloi në pronësi znj. R. M, që në momentin e blerjes së apartamentit në datën e lidhjes së kontratës së shitjes. Pas blerjes së apartamentit, u vura në dijeni nga R. për disa vështirësi

lidhur me kalimin e pronësisë në emrin tim, pasi R. vepronte në llogari e interes timin, por duke qenë e papajisur me akt përfaqësimi, pasqyrohej në kontratë si blerëse. Për t'i vërtetuar shoqërisë “{***}” dhe të tretëve qëllimin e vërtetë të kryerjes së këtij veprimi nga R., për blerje apartamenti për fitimin e pronësisë së tij nga unë, kam përpiluar e nënshkruar deklaratat datë 20.08.2008 e 28.12.2008. Në këto deklarata shpjegoj mënyrën se si është vepruar për këtë pasuri e të tjera, që shoqëria shitëse e apartamentit të kuptonte natyrën e vërtetë të veprimit e të vazhdonte procesin e kalimit të pronësisë në emrin tim, pa pengesa të mëtejshme. [...] Pas blerjes së apartamentit, në mungesën time, R. është përkujdesur për të, për ndonjë problem me administratorët e pallatit, deri disa kohë para martesës. Pas blerjes së apartamentit në vitin 2007, unë kam vepruar si pronar i tij”.

84.4 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 03.12.2018, znj. R. J, lidhur me shumën prej 13.000 eurosh, të pretenduar si të përfituar nga marrëveshje ndërmjetësimi për blerje pasurie për të afërmit e saj, bën të njëjtat deklarime si z. S. K në deklaratën noteriale të pasqyruar më sipër.

84.5 Me kontratën e shitjes me rezervë nr. {***} prot., datë 23.03.2007, z. G. Gj. ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK apartamentin {***}, kulla {***}, me sipërfaqe ndërtimi 68,2 m², i ndodhur në katin e tretë nga toka, në rrugën “{***}”, Tiranë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, shoqëria “{***}” ShPK, pas likuidimit të vlerës së plotë të apartamentit dhe firmosjes së procesverbalit të marrjes në dorëzim, parashikuar brenda muajit prill 2007, do të merrte të gjitha masat për hartimin e kontratës së shitblerjes, si dhe për regjistrimin e saj në ZRPP, brenda afatit kohor prej 12 muajsh. Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së apartamentit të jetë 52.000 euro, vlerë që blerësi e ka paguar me nënshkrimin e kësaj kontrate. Me vërtetimin nr. {***} rep., {***}kol., datë 26.03.2007, notere R. S ka vërtetuar nënshkrimin rregullisht, përpara saj, të kontratës nga palët.

84.6 Më datë 26.03.2007, z. G. Gj ka hartuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 26.03.2007, redaktuar nga notere R. S, në të cilën deklaron se në bazë të kontratës noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.03.2007, ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, apartamentin {***}, kulla v, me sipërfaqe ndërtimi 68,2 m², i ndodhur në katin e tretë nga toka, në rrugën “{***}”, Tiranë. Për blerjen e apartamentit ka shlyer të gjithë shumën e caktuar. Më tej, ai vijon: “Meqenëse këtë apartament ia kam shitur znj. R. M, heq dorë nga blerja e tij. Unë kam marrë nga znj. R. M shumën prej 52.000 eurosh, shumë e cila më është dorëzuar jashtë zyrës noteriale. Apartamenti është i përfunduar dhe i dorëzohet blerëses në prill 2007”.

84.7 Në të njëjtën datë është lidhur kontrata nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 26.03.2007, mes z. G. Gj në cilësinë e shitësit dhe znj. R. M në cilësinë e blerësit, redaktuar nga notere R. S. Duke qenë se apartamenti nuk është regjistruar në ZRPP e, për pasojë, palët nuk mund të lidhnin kontratën përfundimtare të shitjes, kanë përcaktuar këto kushte: “1) Apartamenti që shitet ka {***}, kulla {***}, me sipërfaqe ndërtimi 68,2 m², i ndodhur në katin e tretë nga toka, në rrugën “{***}”, Tiranë. 2) Shuma për shitjen e apartamentit është 52.000 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale. 3) Apartamenti do të dorëzohet brenda muajit prill 2007. 4) Që në këtë moment, kontaktet për vazhdimin e pjesëve të papërfunduara në apartament, ndërtuesi do t'i vazhdojë me blerësen R. M.. 5) Kontrata e lidhur me shitësin dhe shoqërinë ku specifikohet ndërtimi i apartamentit, pajisjet e përdorura etj., do të mbetet në fuqi dhe do të zbatohet për blerësen R. M. 6) Blerësja R. M. nuk ka asnjë detyrim për regjistrimin e apartamentit dhe as me detyrimet ndaj shtetit, detyrimi i saj është pagesa e kontratës noteriale dhe regjistrimi i apartamentit në emrin e saj në ZRPP, kur të bëhet kontrata e shitjes ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe znj. R. M”.

84.8 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.20.2013, znj. J. Gj. deklaroi se jep pëlqimin për shitjen e bërë nga bashkëshorti i saj, z. G. Gj., të blerësja, znj. R. M, të apartamentit me sipërfaqe ndërtimi 68,2 m² në rrugën “{***}”, Tiranë, i ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK.

84.9 Sipas dokumentacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP Tiranë⁴⁶, znj. A. K. [bashkëshortja e z. S. K dhe teza e znj. R. J] është pronare e pasurisë nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, në zonën kadastrale {***}, apartament me sipërfaqe totale 61,2 m² në rrugën “{***}” Tiranë, pasuri kjo e regjistruar në emër të saj, më datë 29.10.2015, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2015. Për regjistrimin e kësaj pasurie ka aplikuar vetë znj. A. K.

Në praktikën e kësaj pasurie, të përcjellë nga ZVRPP Tiranë gjendet:

- Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2015, e lidhur ndërmjet shoqërive “{***}” ShPK e “{***}” ShPK në cilësinë e palës shitëse dhe znj. A. K në cilësinë e palës blerëse, për shitblerjen e pasurisë nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, në zonën kadastrale {***}, në rrugën “{***}” Tiranë.

Sipas nenit 4 të kontratës, pasuria objekt kontrate shitet kundrejt çmimit total prej 43.260 eurosh ose 5.474.985 lekësh. Në nenin 5 të kësaj kontrate, shitësi deklaroi se blerësi e ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme, sipas kontratës së shitjes me rezervë me nr. {***}, datë 23.03.2007.

- Kontratë nr. {***} prot., datë 23.03.2007, e lidhur mes znj. A. K dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Referuar kësaj kontrate, rezultoi se znj. A. K ka blerë nga kjo shoqëri apartamentin {***}, kulla {***}, me sipërfaqe ndërtimi 68,2 m², i ndodhur në katin e tretë nga toka, me orientim juglindje, në rrugën “{***}”, Tiranë, për çmimin e shitjes prej 43.260 eurosh dhe se znj. K e ka paguar këtë shumë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

- Vërtetim pagese, datë 22.10.2015, i lëshuar nga shoqëritë “{***}” ShPK e {***}” ShPK, sipas të cilit znj. A. K ka likuiduar shumën prej 43.260 eurosh ose prej 5.474.985 lekësh për blerjen e apartamentit {***}, kati i tretë, me sipërfaqe 68,2 m², në rrugën “{***}”, Tiranë. Ky vërtetim është lëshuar me kërkesë të klientit.

84.10 Shoqëria “{***}” ShPK, informon Komisionin⁴⁷ se ajo së bashku me shoqërinë “{***}” ShPK, në datën 22.10.2015, kanë lidhur kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., me znj. A. K, për apartamentin {***}, Kulla {***}, me sipërfaqe 61,2 m² (sipërfaqe totale 68,2 m²), bazuar në kontratën e shitjes me rezervë nr. {***} prot., datë 23.03.2007. Gjithashtu, shoqëria informon se me z. G. Gj është lidhur kontratë shitjeje me rezervë me nr. {***} prot., datë 23.03.2007, por në të njëjtën ditë kjo kontratë është revokuar me një deklaratë nga z. G. Gj. Si rrjedhim, duke qenë se apartamenti ishte i lirë, iu shit në të njëjtën datë znj. A. K. Për sa i përket çmimit të shitjes, shoqëria shpjegon se ai është rezultat i marrëveshjes mes palës shitëse dhe blerëse.

Shoqëria “{***}” ShPK, përveç informacionit që gjendet edhe në praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP, në emër të znj. A. K, dhe që është përshkruar më sipër në këtë vendim, ka përcjellë edhe deklaratën e z. G. Gj, e hartuar më datë 23.03.2007, në selinë e shoqërisë “{***}” ShPK, i cili deklaroi se: “Në bazë të kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} prot., datë 23.03.2007, lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK si palë shitëse dhe meje, G. Gj., si palë blerëse, unë kam blerë një pasuri të llojit apartament {***}, kulla {***}, me sipërfaqe ndërtimi në total 68,2 m², në rrugën “{***}”, Tiranë. Unë deklaroj se heq dorë nga apartamenti i sipërpërshkruar, duke deklaruar se nuk kam asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm. Për apartamentin nuk kam depozituar asnjë shumë monetare”.

⁴⁶ Informacioni është përcjellë në Komision nga ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.03.2019.

⁴⁷ Informacioni i përcjellë në Komision nga shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.03.2019.

85. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se nuk rezulton e provuar se personi i lidhur - bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit - ka përfituar shumën 13000 euro nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim dhe përfaqësim për blerjen e një apartamenti, për interes e llogari të z. S. e znj. A. K., bazuar në arsyetimin si vijon.
Në deklaratën noteriale të vitit 2014, z. S. K ka deklaruar se marrëveshja e bërë me znj. R. J [M] ishte e tillë që, në rast se apartamenti i kërkuar do të blihej nga znj. J. në një vlerë më të ulët se vlera 65.000 euro që ai i kishte dhënë në dorë, diferenca do t'i kalonte asaj në pronësi që në momentin e blerjes së apartamentit, me kusht që të përkujdesej për këtë apartament, deri në kalimin e pronësisë në emrin e tij. Znj. J., në deklaratën e saj noteriale të vitit 2018, dhe subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision⁴⁸, kanë pranuar se znj. J. është marrë pak kohë me çështjet e administrimit të banesës pas blerjes, e më tej nuk është marrë më, pasi pas vitit 2010 është zhvendosur me banim e punësim në Fier, duke mos plotësuar kështu kushtin për të cilin z. K. pretendon se i ka dhënë asaj shumën prej 13.000 eurosh - përkujdesjen për apartamentin, derisa ai të kalonte në pronësinë e tij - sipas dokumentacionit deri në vitin 2015, kur është vërtetuar se pronësia e këtij apartamenti i ka kaluar bashkëshortes së tij.
86. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshortja e tij ka kryer blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68,2 m², në vitin 2007, për llogari të z. S. e znj. A. K., pasi ata jetonin në Athinë, Greqi, nga të dhënat e sistemit TIMS të paraqitura si provë nga subjekti dhe të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se z. S. e znj. A. K kanë ardhur disa herë në Shqipëri në vitin 2007 dhe Greqia nuk është në një largësi të konsiderueshme, që e bën të pamundur ardhjen e një individi për kryerjen e një veprimi juridik, për një investim të rëndësishëm si blerja e një pasurie të paluajtshme.
87. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kontrata e shitjes me rezervë nr. {***} prot., datë 23.03.2007, nuk është lidhur në të vërtetë nga znj. K., pasi siç vërtetohet nga të dhënat e sistemit TIMS, znj. K. nuk ka qenë në Shqipëri në këtë datë, trupi gjykues e konsideron si një fakt jorelevant për zgjidhjen e çështjes, pasi i besueshëm dhe i rëndësishëm mbetet fakti tjetër i pakundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, se znj. A. K ka lidhur personalisht, kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2015, me shoqëritë “{***}” ShPK e “{***}” ShPK, sipas së cilës ka paguar vlerën 42260 euro për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68,2 m². Kjo kontratë ka dhënë pasojat juridike të dëshiruara nga palët, pasi apartamenti i blerë nga znj. A. K është regjistruar në ZVRPP Tiranë, më datë 29.10.2015.
88. Subjekti i rivlerësimit, megjithëse në ankim pretendon se apartamenti i blerë nga znj. A. K në vitin 2015, është i njëjti që ka blerë bashkëshortja e tij në vitin 2007, nuk ka shpjeguar në asnjë moment, as gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as në ankim, se çfarë ka ndodhur me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2007, së lidhur mes znj. R. J dhe z. G. Gj., e cila bazuar në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2013, e znj. J. Gj, bashkëshorte e z. G. Gj., në të cilën shprehet se jep pëlqimin për shitjen e bërë nga bashkëshorti i saj te R. M. për apartamentin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, rezulton se ka qenë në fuqi deri në vitin 2013. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se kontrata e lidhur mes z. Gj. dhe znj. J. është revokuar pas vitit 2013.
Subjekti, megjithëse në ankim pretendon faktin se apartamenti i blerë nga znj. K. në vitin 2015, është i njëjti që ka blerë bashkëshortja e tij në vitin 2007, nuk parashtron asnjë argument për faktin pse znj. A. K e ka blerë atë me një çmim më të lirë se bashkëshortja e tij, pra ka arritur një marrëveshje më favorizuese me palën shitëse sesa përfaqësuesja e pretenduar e saj, në vitin 2007. Në këtë kuadër, subjekti nuk ka sqaruar as se çfarë ka

⁴⁸ Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ.

ndodhur me shumën prej 52000 eurosh që znj. J. i kishte likuiduar z. Gj .në vitin 2007⁴⁹. Subjekti, megjithëse ka pretenduar se znj. A. K nuk ka paguar dy vlera për blerjen e të njëjtit apartament, nuk ka shpjeguar e as provuar me akte mbështetëse se ka ndodhur kthimi i kësaj shume, të paktën pas vitit 2013, nga z. G. Gj te znj. R. J dhe më pas nga znj. J. te znj. A. K., për të bërë të mundur prej kësaj të fundit pagesën e vlerës 43260 euro për blerjen e apartamentit në vitin 2015⁵⁰.

89. Znj. A. K., kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2015, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68,2 m² e ka lidhur me shoqëritë “{***}” ShPK e “{***}” ShPK, duke hyrë në marrëdhënie juridike vetë personalisht, megjithëse kishte lëshuar prokurën e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.09.2015, sipas së cilës emëronte si përfaqësuesen e saj znj. R. J., së cilës ndër të tjera i jepte dhe të drejtën për të lidhur kontrata shitblerjeje, kontrata porosie me shoqëri të ndryshme ndërtimi, kontrata qiraje, kontrata huapërdorje të pasurive të saj. Ky fakt, i parë në harmoni edhe me të dhënat e tjera të rezultuara nga situata faktike e analizuar më sipër në këtë vendim, se nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë se kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 26.03.2007, e lidhur mes znj. R. J dhe z. G. Gj, është lidhur për llogari të z. S. e znj. A. K., përveç deklaratës noteriale të z. S. K., e redaktuar në vitin 2014, e cila siç ka pranuar dhe vetë subjekti i rivlerësimit, është lëshuar për efekt të procesit të kontrollit të kryer ndaj pasurisë së tij në këtë vit, nga ILDKPKI, dhe nuk është e shoqëruar me asnjë dokumentacion provues, krijon bindjen se përfaqësimi e ndërmjetësimi për blerje apartamenti për llogari të z. S. e znj. A. K nga znj. R. J., nuk ka ndodhur. Edhe shoqëria “{***}” ShPK nuk ka konfirmuar të ketë hyrë në marrëdhënie juridike me persona të tjerë, përveç znj. A. K., për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 68,2 m², në Tiranë.

Në këto kushte, veprimi i dhënies së shumës prej 13000 eurosh, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nga bashkëshortët K. për përfaqësim e ndërmjetësim për blerje apartamenti 68,2 m² në Tiranë, në vitin 2007, duket dhe vlerësohet i pabesueshëm për trupin gjykues, pasi nuk u provua në asnjë rast se znj. R. J kishte vepruar si përfaqësuese e tyre në blerjen e pasurisë, pra të ishte realizuar qëllimi i pretenduar prej saj për marrjen e shumës 13000 euro. Për pasojë, kjo shumë nuk është konsideruar si e tillë as në analizën financiare të kryer në Kolegj, për të verifikuar mundësitë financiare të bashkëshortes së subjektit për të krijuar depozitat bankare në vitin 2009.

90. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në bazë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, bashkëshortja e tij është në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion për veprime që janë kryer rreth 10-20 vjet më parë e, për këtë arsye, Komisioni duhet të kishte pasur parasysh parimet e objektivitetit e proporcionalitetit, për të vlerësuar rrethanat e kohën kur janë kryer veprimet. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit në raport me përcaktimin e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i cili vendos mbi subjektin detyrimin për t’i vërtetuar institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, trupi gjykues vëren së pari, se subjekti i rivlerësimit nuk ka cilësuar/identifikuar se cili është dokumentacioni i pamundur objektivisht për t’u

⁴⁹ Likuidimi i kësaj vlere nga znj. R. J te z. G. Gj. është rikonfirmuar në vitin 2013, me anë të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2013 e znj. J. Gj., bashkëshorte e z. G {***} Gj.

⁵⁰ Në vijim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se kontrata e shitjes me rezervë nr. {***} prot., datë 23.03.2007, e lidhur mes znj. A. K. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, nuk mund të ishte lidhur nga znj. A. K., pasi ajo nuk ka qenë në Shqipëri në këtë datë, sipas të dhënave të sistemit TIMS.

siguruar nga bashkëshortja e tij dhe së dyti, edhe nëse do të ishte identifikuar dokumentacioni, subjekti nuk ka vërtetuar se ka ezauruar të gjitha mënyrat e kërkimit për gjetjen e tij. Për më tepër, ky pretendim vlerësohet jokonsekuent, me pretendimin tjetër të parashtruar nga subjekti, gjatë hetimit administrativ dhe në ankim, se veprimet e bashkëshortes së tij janë kryer në mungesë të hartimit të akteve të duhura ligjore dhe shumat e pretenduara si të përfituara prej saj, i janë dhënë në dorë nga të afërmit e saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se është i paargumentuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

91. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, në vendim⁵¹, se personi i lidhur ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet gjendje në llogari bankare depozite në fund të vitit 2009, në vlerën 2.442.944 lekë, duke pretenduar se Komisioni, në mënyrë të padrejtë dhe pa u bazuar në prova, nuk ka përfshirë në analizë financiare shumën prej 13.000 eurosh, të përfutur nga bashkëshortja si rezultat i kryerjes së veprimeve në emër e për llogari të znj. A. e z. S. K për blerjen e një apartamenti, si dhe shumën 1.000.000 lekë dhuruar bashkëshortes nga znj. A. e z. S. K për qëllime studimi, e cila është shpenzuar në fakt nga bashkëshortja për shpenzime jetese gjatë viteve 2005-2009. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu se Komisioni, në analizën financiare, nuk ka shpjeguar metodologjinë e përdorur për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortes, për vitin 2005, vit në të cilin ajo ka përfunduar studimet, në kushtet kur nuk ka marrë në konsideratë shumën prej 1.000.000 lekësh, shumë e pretenduar nga Komisioni si e përdorur vetëm për qëllime studimi.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se analiza financiare e Komisionit për të verifikuar mundësinë e znj. J. për të krijuar kursimet bankare në vitin 2009 është kryer për periudhën 2005 - 31.12.2009, periudhë në të cilën znj. J. ka qenë në marrëdhënie pune, pa përfshirë në përlllogaritje vlerën 1.000.000 lekë, dhuruar nga të afërmit e saj në vitin 2002. Komisioni, në këtë mënyrë përlllogaritjeje, ka qenë konsekuent i arsytimit të tij se shuma prej 1.000.000 lekësh, e dhuruar nga të afërmit e znj. J. vetëm për përballimin e studimeve, duke qenë se nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2010 nga znj. J. si burim krijimi i depozitave, nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare. Për këtë arsye, pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka shpjeguar metodologjinë e përdorur për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortes, për vitin 2005, në kushtet kur nuk ka marrë në konsideratë shumën prej 1.000.000 lekësh, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në mbështetje të arsytimit të bërë më sipër dhe konkluzioneve të arritura në paragrafët 81 dhe 88 në këtë vendim, rezulton se konfirmohet rezultati i analizës financiare të kryer në Komision, për mungesën e burimeve të ligjshme financiare të znj. R. J., për të krijuar depozitat e saj në vitin 2009, depozita mbi të cilat ka vazhduar ecuria e shtimit dhe pakësimit të likuiditeteve financiare deri në momentin e deklaramit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues çmon të theksojë se nëse do të verifikohej mundësia e znj. J. për të krijuar këto depozita deri në datën e çeljes së tyre, datë 26.08.2009, atëherë rezultati i prodhuar do të ishte një mungesë burimesh në vlerën 2.339.234 lekë, gjithsesi një bilanc negativ.

⁵¹ Paragrafin 48.12 i vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitave të deklaruara për vitin 2009, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimi i tij gjendet i pabazuar.

92. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në shkaqet e ankimit, parashtrimet e paraqitura prej tij me shkrim 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, si dhe të gjitha provat e aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në përfundimin se vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, i Komisionit është i drejtë, bazuar në konkluzionet si vijojnë, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

92.1 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë depozitë në shumën 3011 euro në Bankën Raiffeisen, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

92.2 Subjekti i rivlerësimit ka qenë në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e likuiditeteve për vitin 2008, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

92.3 Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me të drejtën e përdorimit për pasuritë apartament me sipërfaqe 170 m² dhe bodrum me sipërfaqe 22 m², në lagjen “{***}” në Fier, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

92.4 Në lidhje me depozitat e deklaruara në emër të personit të lidhur, bashkëshortes së tij:

a) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtyre depozitave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) bashkëshortja e tij ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e këtyre depozitave në vitin 2009, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

93. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
94. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha akteve e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit, bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Roland Jaupaj ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
95. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, vlerëson se vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 150, datë 28.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.09.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi